

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7885 E premte 17 Maj 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Estonia është një shtet i vogël në Europën Veriore në Detin Baltik, me pak më shumë se 1,3 milion banorë. Ngjason me ne, Shqipërinë jo vetëm nga ...

Vijon në faqen 20

Nga IGLI TOLA

Modeli ekonomik estonez...



Opinion i Ditës

Nga KLODIAN MUÇO

A do integrohemi ndonjëherë në BE?



Gazmend Bardhi: Ka rrezik manipulimi PD fut komisionerët në zgjedhje. Rama: Nuk dorëhiqem, nuk do shtyhen zgjedhjet

Rudina Hajdari: PS-PD kanë bërë marrëveshje të re. Vetingu në polici, Kuvendi rrezon dekretin e Metës

Mazhoranca nuk tërhiqet nga pozicioni i saj, duke u shprehur e vendosur që zgjedhjet vendore të mbahen në 30 qershor. Kryeministri Edi Rama, i pranishëm në emisionin "Opinion", në TV "Klari" theksoi se zgjedhjet nuk do të shtyhen dhe ai vetë personalisht nuk do të japë dorëheqjen për t'i hapur rrugë krijimit të një qeverie transitore. Para një paneli ...

Në faqen 3

QEVERIA U NJEH PRONESINE E TRUALLIT 2000 PRONAREVE NE TE GJITHE VENDIN

NDERTIMET PA LEJE, LISTA: TAPITE PER 1 MIJE FAMILJE

Emrat në Tiranë dhe në rrethe. Paratë e kompensimit, 510 përfitues ndajnë 230 milionë lekë. Dokumentet që nevojiten, karta e identitetit dhe llogaria bankare



(Në foto) Ndertime informale në Tiranë

BURG EDHE PER 8 ZYRTARE

Falsifikuan pronat në plazhin e Spillesë, dënohet ish-kreu i Hipotekës

Në faqen 6

REFORMA

Skënder Gjinushi, kandidat i vetëm për kryetar të Akademisë së Shkencave

Në faqen 18

TRAFIK DHE ARME

Grabitje me armë në Greqi, zbulohet e prangoset banda e shqiptarëve

Në faqen 2

KOSOVE

Deputetja publikon foto përdhunimi të serbëve, prokuroria: Do të nisim hetimet

Në faqen 16

SUKSESI NE TEL AVIV



Festivali i këngës, Jonida Maliqi kalon në natën finale në Eurosong

Në faqen 19

Kryetarja e LSI: Dhuna nuk na favorizon, protestat nuk do t'i ndalojmë

Kryemadhi në SHBA: Pakt kombëtar mes partive

"Petrit Vasilin i është refuzuar viza amerikane? Nuk vë dorën në zjarr"

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se ka kapur institucionet. Ajo tregoi se Rama ka në dorë reformën në drejtësi dhe shtoi se dosjet e përfolura nga opozita dëshmojnë se Rama ka vjedhur votat në 2017-ën. Kryemadhi, e ftuar



në "Zërin e Amerikës" sugjeroi se i se partitë politike shqiptare duhet të bëjnë një pakt kombëtar. E pyetur për dy protestat më të fundit të opozitës, Kryemadhi deklaroi: "Dënojmë çdo lloj dhune, edhe ndaj policisë, edhe ndaj qytetarëve ..."

Në faqen 4

KRIZA POLITIKE MAZHORANCA

Dekreti i kreut të shtetit u rrëzua me 79 vota kundër, përfshi edhe vota nga opozita

Vetingu në polici, Kuvendi rrëzon dekretin e Metës, kontrolli nga SHÇBA

"Vetingu në polici është i domosdoshëm dhe urgjent"

Kuvendi nuk i ka pranuar argumentet e Presidentit të Republikës dhe ka hedhur dekretin e tij, me anë të të cilit rrëzoi ndryshimet e bëra në ligjin për vetingun në polici. Me 79 vota kundër (kundër votuan edhe disa deputetë të opozitës) dhe 11 pro, Kuvendi ka rrëzuar dekretin e kreut të shtetit, ndërsa ka lënë në fuqi ndryshimet që iu bënë ligjit për vetingun në polici, të cilat këtë proces ia kalojnë në përgjegjësi Sherbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesave. Kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla dhe ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, gjatë fjalës së tyre në Kuvend bënë thirrje që deputetët të votojnë rrëzimin e dekretit të Metës. Ata u shprehën se ky proces është shumë i nevojshëm dhe duhet të nisë sa më shpejt. "Në mënyrë të pritshme, pasi bllokuan për dy vite në parlament zbatimin e reformës në drejtësi, Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, vendosi të kthejë për rishqyrtim ligjin për vetingun në Policinë e Shtetit, një hallkë e pandalshme e vijimit të reformës në drejtësi. Vetingu në polici është i domosdoshëm dhe urgjent. Çdo përpjekje për ta penguar edhe këtë proces do të dështojë, sepse sot mazhoranca e Partisë Socialiste në Kuvendin e Shqipërisë do ta rrëzojë dekretin e Presidentit Meta. Ftesa ime për deputetët e rinj të parlamentit është që të bashkoheni në nevojën për të vijuar këtë proces të rëndësishëm dhe për ta mbështetur", - tha Balla. Ndërkohë, ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, u shpreh nga foltorja e Kuvendit se me rikthimin e ligjit të vetingut në polici është harxhuar kohë e tepër për një temë dhe çështje, që sipas tij në të vërtetë nuk ekzistojnë. "Është harxhuar kohë presidenciale për t'u marrë me këtë temë, tani parlamentare, për një temë që nuk ekziston. Ligji nuk ndryshon në substancë, ndryshime të natyrës kozmetike, që nuk prekin ligjin e vjetër. Ai parashikon që vetingu të kryhet për të gjithë punonjësit e policisë dhe një komision të jashtëm, që do të kryente vlerësimin, edhe në ligjin e ri është ky komision. Në fazën e dytë dhe të tretë të angazhohen punonjësit që janë varësi të SHÇBA-së, asnjë ndryshim nuk ka ligji i ri me këtë vjetrin", - tha Lleshaj. Ai gjithashtu theksoi se nëpërmjet ndryshimeve të reja në ligj nuk humbet pa-



Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj

BALLA

"Vetingu në polici është i domosdoshëm dhe urgjent. Çdo përpjekje për ta penguar edhe këtë proces do të dështojë, sepse sot mazhoranca e PS në Kuvendin e Shqipërisë do ta rrëzojë dekretin e Presidentit Meta. Ftesa ime për deputetët e rinj të parlamentit është që të bashkoheni në nevojën për të vijuar këtë proces të rëndësishëm dhe për ta mbështetur", - tha Balla.

PROPOZIMI

Deputeti i opozitës, Lefter Maliqi, ka propozuar dje gjatë diskutimit të dekretit për vetingun që deputetëve t'u përgjysmohet paga dhe t'u rritet policëve. "Unë jam gati vetë edhe si deputet, të ulet rroga e deputetëve, vetëm policët të kenë paga më të mira", - u shpreh deputeti demokrat.



Seanca e dëshme parlamentare

Lefter Maliqi: Drejtori i Burgjeve një i dënuar, u thotë policëve kaqola

Ish-nëndrejtori i Burgjeve, aktualisht deputet në Kuvendin e Shqipërisë, Lefter Maliqi, ka zhvilluar dje një interpelancë me ministrin e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, mbi situatën e burgjeve, duke sulmuar ashpër kreun e këtij institucioni, Agim Ismaili. Në fjalën e tij, deputeti u shpreh se situata në burgje është problematike dhe problemi kryesor është drejtuesi i tyre, Agim Ismaili. Ai tha se kreu i Burgjeve nuk është personi kompetent për të mbajtur postin, ndërsa shtoi se në të gjitha postet shtetërore që ka mbajtur më parë, Ismaili është kapur në shkelje ligjore. Gjithashtu, Maliqi theksoi se drejtori i Burgjeve ka kërcënuar përmes 'e-mail'-eve punonjëset femra të burgjeve, ndërsa përdor një fjalor të papërshtatshëm për policët, duke i vendosur etiketime nga më të ndryshmet ofenduese. "Ju kemi



emëruar drejtor të përgjithshëm të Burgjeve një njeri me probleme shumë të mëdha. Unë jua kam shprehur shqetësimin edhe juve edhe zotit kryeministër. Meqë iu dhimbset Drejtoria e Burgjeve, e para çfarë shkolle ka mbaruar ky person? Më rezultojnë që ka mbaruar 'Kristalin'; e dyta, a e keni parë të shkuarën e tij që është liruar nga policia ku akuzohet për lidhje ndërkombe të drogës? Në 2004-ën shkarkohet për paafësi në

detyrë, për fyerje dhe shantazhe. Tani bëhet drejtor i përgjithshëm i Burgjeve, nuk i njeh, për katër muaj ka shkuar vetëm një Fier, por çon e-mail, shantazhon, drejtorët nuk i pret. Kërcënim dhe shantazhe me drejtorin e Policisë së Burgjeve. Ai kërcënon policët femra, u thotë dordolec policëve. U thotë policëve kaqola. Ka kërkuar të shkarkojë dy apo tri herë kunatin e nënkryetarës së Kuvendit", - tha Maliqi.

varësia e organeve që do të bëjnë vetingun në Policinë e Shtetit. "Edhe për merakun tjetër që hyn SHÇBA në lojë, ka qenë e futur edhe me ligjin e parë, që nuk caktonin sa pjesëtarë ishin nga

SHÇBA etj. Pse duhet rrëzuar ky argument, sepse në të kundërt rrëzojmë vetingun. Vetingu duhet të mbyllet në mars të 2020-ës, ndërsa ende nuk ka filluar dosja e parë. A mund të bëjë kush

aritmetikë minimale për të thënë se mund të mbyllet vetingu. Kushdo që është në favor të vetingut duhet të jetë në favor të rrëzimit të dekretit. Verifikimi i integritetit të çdo punonjësi do të

Betohen 11 deputetë të rinj, Kuvendi me 121 anëtarë

Kuvendi vijon të plotësojë vendet vakante të lëna nga dorëzimi i mandateve të deputetëve të opozitës reale. Pasi morën mandatin nga KQZ-ja si pasojë e vakancave të krijuara pas dorëzimit të mandatit nga deputetët e PD dhe LSI, dje në Kuvend u betuan plot 12 deputetë të rinj, duke e çuar numrin total të anëtarëve të Kuvendit në 121. Kështu, dje u betua deputeti më i ri Kuvendit, Selami Jenisheri, që vjen nga Partia e Pensionistëve dhe që në zgjedhjet e shkuara parlamentare konkurroi në listat e Partisë Demokratike për Tiranën. Një tjetër deputet që u betua ishte Besnik Troplini, i cili po ashtu vjen nga lista shumëemërore e PD-së për Tiranën. Kuvendit iu shtua edhe Suzana Topi, që vjen nga lista shumëemërore e LSI-së për Elbasanin. Gjithashtu, u betua edhe kandidati i radhës në listën shumëemërore të Partisë Demokratike, qarku Durrës, Krenar Rryçi, si dhe Kostaq Papa nga lista e PD-së për Tiranën. Gjatë seancës së djeshme u betua edhe Halit Valteri nga listat e PD-së për Tiranën si dhe Vasil Strejovski nga lista e LSI-së për qarkun Korçë. Gjithashtu, pas vakancave të krijuara prej dorëheqjes së disa deputetëve të PS-së pasi kandidojnë si kryetarë bashkie, KQZ vendosi t'u japë mandatin e deputetit 4 kandidatëve nga listat shumëemërore të PS. Kështu, sot në Kuvend u betuan Eljo Hysko, Adriana Jaku, Florenc Spaho dhe Ardit Konomi.



jetë një proces që nuk mbaron kurrë. Është krijuar SHÇBA, që ka për detyrë të realizojë vetingun sot e mot. Çdo hyrje e re duhet të kalojë në veting, por nuk është certifikatë e përjet-

shme, gjatë rrugës janë infektuar e korruptuar", - u shpreh Lleshaj. Tashmë, me rrëzimin e dekretit presidenti nuk ka më mundësi të shprehët dhe ligji hyn automatikisht në fuqi.



Kreu i qeverisë refuzoi të pranojë kërkesën e opozitës për të dhënë dorëheqjen

Rama: Zgjedhjet nuk shtyhen, nuk jemi te fusha e vogël e Surrelit

"Këtë logjikë unë e përdor me Zahon, pra kur luajmë"

Mazhoranca nuk tërhiqet nga pozicioni i saj, duke u shprehur e vendosur që zgjedhjet vendore të mbahen në 30 qershor. Kryeministri Edi Rama, i pranishëm në emisionin "Opinion", në TV "Klan" theksoi se zgjedhjet nuk do të shtyhen dhe ai vetë personalisht nuk do të japë dorëheqjen për t'i hapur rrugë krijimit të një qeverie transitore. Para një paneli gazetarësh të njohur, kreu i qeverisë tha se nuk mund t'i hapet rrugë paligjshmërisë, duke u shprehur se kërkesat e opozitës janë antikush-tetuese. "Ne kemi një shprehje që budallait hapi rrugë, në kuptimin që një personi të del përpara dhe të shfaqet me forma që mund të rrezikojë, për ta shmangur duhet t'i hapësh rrugë. Por, shteti nuk funksionon kështu, atyre që sfidojnë Kushtetutën dhe format e bashkëjetesës se ne do ju hedhim në erë, nuk mund t'i hapet rrugë", - tha Rama. Kreu i qeverisë u shpreh se këtyre kërkesave nuk mund t'i hapet rrugë edhe për shkak se kjo do vendoste një precedent të rrezikshëm sa herë që ka zgjedhje. "30 qershori është data e zgjedhjeve vendore, që nuk është datë që e kam vendosur unë. Unë nuk di që qeveria dhe shumica qeverisëse e këtij vendi të ketë marrë një vendim të tillë për të shtyrë zgjedhjet. Nëse qeveria ose shumica ka marrë ndonjë iniciativë që të pengojë opozitën të hyjë në zgjedhje, Opozita nuk mundet dot që një këndvështrimin e vet mbi një temë sado të rëndësishme të shtojë në një problem për të gjithë vendin dhe të thotë 'o ik ti, o s'ka zgjedhje'".



Kryeministri Edi Rama, dje në emisionin "Opinion"

DORËHEQJA
"Nëse për 1 sekondë të vetme unë do mendoja që po të ikja unë këtu do normalizohet gjithçka, s'do të isha këtu, por do kisha ikur. Nëse unë do mendoja që të nesërmen e ikjes sime Saliu do të bëhej njeri, unë do të kisha ikur. Por, nuk është çështje personi, është çështje e një sistemi që ne duhet ta ndërtojmë për fëmijët. Kemi një komizë të caktuar dhe brenda një komize ne ulemi dhe flasim".

ZGJEDHJET

"30 qershori është data e zgjedhjeve vendore, që nuk është datë që e kam vendosur unë. Unë nuk di që qeveria dhe shumica qeverisëse e këtij vendi të ketë marrë një iniciativë ligjore që të pengojë opozitën të hyjë në zgjedhje. Opozita nuk mundet dot që një këndvështrimin e vet mbi një temë sado të rëndësishme të shtojë në një problem për të gjithë vendin dhe të thotë 'o ik ti, o s'ka zgjedhje'".



Opozita e re: Rama dhe Basha kanë bërë pakt të fshehtë kundër shqiptarëve

Deputetët e opozitës së re parlamentare hedhin dyshime se mes kryetarit të mazhorancës, Edi Rama dhe kreut të opozitës, Lulzim Basha është arritur tashmë një marrëveshje për të ndarë pushtet dhe jo në interes të qytetarëve. Rudina Hajdari dhe Ralf Gjoni i kanë kërkuar shumicës qeverisëse të japë shpjegime në goftë se po punojnë për një marrëveshje me opozitën, duke shprehur shqetësimin se Rama dhe Basha nuk mendojnë për qytetarët, por për pazaret e tyre. "Në Tiranë zhvillohet një teatër i shëmtuar i marrëveshjeve të pasqorë, të njerëzve që po shikojnë dashurinë e tyre në kohën e kolerës. Këta kanë bërë marrëveshje, por jo marrëveshje për Shqipërinë dhe shqiptarët por zuzarët", - tha deputetja Rudina Hajdari. "Zoti Balla, a ka marrëveshje politike, sepse kjo mbetet për t'u sqaruar këtu në parlament. Po përfillt në media se Rama dhe Basha po përgatisin marrëveshjen e radhës politike, edhe marrëveshjet politike janë kthyer në një element statistikor. I matni ju këto? Keni 2008 e 2017, mund të bëhet edhe ndonjë tani së shpejti. Kanë parashikuar edhe se kur do të ngrihet Gjykata Kushtetuese dhe çfarë vendimi do të marrë. Çfarë na kanë sjellë në marrëveshjet në gjithë këto vite? Asnjë të mirë, asgjë", - tha deputeti tjetër i opozitës, Ralf Gjoni. Por, shqetësimeve të tyre i është përgjigjur kryetari i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, i cili tha se s'ka asnjë marrëveshje që shkel Kushtetutën, duke garantuar se zgjedhjet do mbahen në 30 qershor: "Zgjedhjet do të mbahen më 30 qershor dhe nuk e luan as topi. Ky është një fakt i padiskutueshëm dhe i panegociueshëm me askënd. Kushtetuta e Shqipërisë është dokument që nuk është llastik, që mund ta tërheqësh ose jo. Kushtetuta është atëherë për t'u respektuar dhe PS është në këtë sallë për ta respektuar. Nuk është PS si ato partitë që ju sullen ju këtu dhe tradhtuan mandatin e shqiptarëve", - tha Balla.

futemi edhe njëherë nga e para. Kur e kemi bërë, se populli ka zgjedhur kush do vijë në qeveri, kush do rrijë në opozitë. Janë disa që po na thonë që jemi të çmendur dhe jemi gati të hidhemi në herë. Nuk ka shans, sepse nuk jemi tek fusha e vogël në Surrelit ku iu lë edhe ndonjë gol, jemi në kushtet kur po flasim për gjëra shumë serioze. Nuk është për të ruajtur postin e kryeministrit, karrigia, posti i kryeministrit nuk është i imi. Nuk është e drejtë që postin e kryeministrit ta përdor si plaçkë, është i këtyre këtu që kanë vendosur të bëjnë detyrën e kryeministrit", tha Rama. Sipas tij, situata

e krijuar është artificiale dhe që vjen pasi forcat opozitare janë në minorancë dhe nuk mund të fitojnë zgjedhjet me votë. "Janë dy forca politike që janë pakicë dhe nuk kanë asnjë mundësi që të fitojnë dhe duan patjetër që të krijojnë një situatë, që ose të marrin pushtet në tavolinë, ose të bëjnë një pazar. Këto të dyja janë dhe s'ka tjetër", - shtoi Rama. Gjithsesi, kryeministri u shpreh se nëse largimi i tij do të kish të normalizuar situatën, ai do ishte larguar nga posti i kryeministrit, por se nuk mund ta bënte këtë kur preket sistemi. "Nëse për 1 sekondë të vetme unë do mendoja që po ika unë këtu

do të normalizohet gjithçka, unë s'do të isha këtu, do kisha ikur. Nëse unë do mendoja që të nesërmen e ikjes sime Saliu do bëhej njeri, unë do të kisha ikur. Por nuk është çështje personi, është çështje e një sistemi që ne duhet ta ndërtojmë për fëmijët. Kemi një komizë të caktuar dhe brenda një komize ulemi dhe flasim. Nëse jeni një mekanizëm si shtyhen zgjedhjet brenda kësaj korizë, ma thoni", tha Rama. Nga ana tjetër, ai u shpreh se opozita ka ngritur një çështje mbi disa përgjime që ai i cilësoi si sallatë fjalësh. "Pyetja është a mundet dot një vend të pushtohet nga këto sallatë fjalësh. Nuk mundet kurrë që një opozitë t'i thotë qeverisë të duhet të ikësh nga këto përgjime. Unë nuk kam të drejtë të thërras asnjë prokuror, prokuroria duhet të hetojë këdo që hyn në zonën e saj të veprimtarisë. Asnjëherë nuk kam dalë dhe të kem folur në mënyrë të tillë që të kem influencuar", - tha Rama. Gjithashtu, kryeministri tha se përveç shprehjes së interesit të përfaqësuesve të partisë gjermane të Merkel për të ndihmuar, nuk ka negociata të tjera të ndërmarra nga ndërkombëtarët. "Ka pasur një shprehje gatishmërie nga miqtë e Shqipërisë, që janë miq të drejtëdrejtë PD-së, të cilët janë shprehur qartazi që palët të ulen në tavolinë pa kushte dhe ne jemi gati të ndihmojmë. Nga ana ime, unë pa kushte ulem edhe pa pasur të tjerë, por ata janë të mirëseardhur. Kaq, tjetër nuk di", - deklaroi Rama.



Berisha: Felaj i mori 150 mijë euro, Shehu tenton vetëvrasjen

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje një tjetër idenonim që ka të bëjë sipas tij me një skandal që po ndodh brenda Partisë Socialiste, tashmë në Kuçovë. Sipas mesazhit të një qytetari të publikuar nga ish-kryeministri Sali Berisha, tregohet se si Sybi Shehu, i cili u përfol në media si kandidat i PS për Bashkinë e Kuçovës, ka tentuar vetëvrasjen. Sipas qytetarit, Shehu ka tentuar të vetëflijohet pasi humbi 150 mijë euro, të cilat ia dha Ermonela Felajt për t'u bërë kandidat për kryetar bashkie, por që gjëmi i tij zgjati vetëm 3 orë, pasi Rama në fund vendosi të kandidojë besnikun e tij, Kreshnik Hajdari.

NGËRÇI POLITIK ZGJIDHJA

Vasilit i është refuzuar viza nga SHBA? Kryetarja e LSI: Nuk e vë dorën në zjarr

Kriza, Kryemadhi: Duhet pakt kombëtar mes partive politike

"Dhuna nuk na favorizon, por protestat s'i ndalim"

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, akuzoi dje kryeminstriin Edi Rama se ka kapur institucionet. Ajo tregoi se Rama ka në dorë reformën në drejtësi dhe shtoi se dosjet e përfolura nga opozita dëshmojnë se Rama ka vjedhur votat në 2017-ën. Kryemadhi, e ftuar në "Zërin e Amerikës" sugjeroi se i se partitë politike shqiptare duhet të bëjnë një pakt kombëtar. E pyetur për dy protestat më të fundit të opozitës, Kryemadhi deklaroi: "Dënojmë çdo lloj dhune, edhe ndaj policisë, edhe ndaj qytetarëve. Sot problem është fenomeni, jo institucionet. LSI-ja do ta bëjë Shqipërinë shtëpinë e shqiptarëve. Duhet të mbyllem transicionin. Jemi vendi i fundit. Po zvarritemi në një rrugë pa drejtimin e duhur. Janë përdorur paratë e krimi të organizuar për të vjedhur votat. Dosja '339' flet për vjedhje votash dhe nuk ka asnjë që të ketë shkuar para gjykatës. Djegia e mandateve është bërë për shkak të situatës politike, pasi Rama ka kapur sistemin e drejtësisë. Rama e ka kapur reformën në drejtësi, të cilën edhe LSI-ja e ka mbështetur. Nën emrin e të ashtuquajturës reformë, kryeministri ka kapur pushtetet. Rama ua ka hequr të drejtën shqiptarëve të kenë institucione të drejta. Më 2017-ën u përdorën paratë e krimi për të vjedhur votat. Ne kemi mësuar gjithçka falë investigimit të 'Zërit të Amerikës'. Pra, prokurorët janë larguar nga dosja '339'. Po e njëjta gjë ka ndodhur edhe me 'Unazën e Re', për të grabitur 20 milionë euro për 2 kilometra rrugë. Unë nuk kam pasur asnjë gjë në dorë dhe sigurisht që të gjithë partitë kanë faj për këtë situatë ku ndodhemi. Sot në radhë të parë duhet të heqim dorë nga pushteti që duan. Partitë duhet të flasin për një pakt kombëtar, për të shkuar më tej në hapat për në BE. Nëse Shqipërinë e lëmë me Kosovën dhe Bosnjën, kjo tregon se do ta lëmë vendin në dorën ruse. Kjo nuk duhet që të ndodhë, për shkak se ne jemi popull



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi dhe Nancy Pelosi, spikere e Dhomës së Përfaqësuesve në Kongresin Amerikan

PAKTI
Nën emrin e të ashtuquajturës reformë, kryeministri ka kapur pushtetet, Rama ua ka hequr të drejtën shqiptarëve të kenë institucione të drejta. Partitë duhet të flasin për një pakt kombëtar, për të shkuar më tej në hapat për në BE", u shpreh Kryemadhi.



Protesta e fundit e opozitës

VASIL

Petrit Vasili ka mohuar që ambasada amerikane t'i ketë mohuar dhënien e vizës amerikane. Në një reagim për "A2CNN", ai ka pohuar se për herë të fundit ka marrë një vizë të tipit A2, tremujore, në qershorin e vitit të kaluar, për të marrë pjesë në një vizitë në Kongresin Amerikan. Prej asaj kohe, ai thekson se nuk ka aplikuar më për vizë në këtë ambasadë. "Viza ka skaduar në shtator dhe që nga ajo datë, nuk ka aplikuar më", - ka deklaruar Vasili.

Protestat, Hahn thirrje opozitës: Kriza dëmton imazhin dhe negociatat

Imazhi aktual i Shqipërisë e vështirëson një vendim pozitiv për hapjen e negociatave. Komisioneri për Zgjerim, Johannes Hahn, në një intervistë për "Deutsche Welle" shprehet se një pamje thotë më shumë se një mijë fjalë. "Natyrisht, imazhi që lë një vend ka ndikim shumë të madh të vendimmarrësimit në Bashkimin Evropian. Këta janë përfaqësuesit e popullit dhe qytetari i thjeshtë që shikon pamjet e transmetuara në televizion e ka të vështirë ta kuptojë kur dëgjon se ky vend na qenka gati për të filluar bisedimet e anëtarësimit në



BE. Pra, edhe një herë apeli im për përgjegjësit është që të jenë të vetëdijshëm për këtë situatë dhe se dihet që një pamje flet më shumë se një mijë fjalë", u shpreh z.Hahn. Zyrta i lartë i BE-së shprehet se është detyrë e qeverisë që t'i afrohet opozitës dhe detyrë e opozitës

që të vetëpërfshihet në mënyrë konstruktive. Në rastin e Shqipërisë, dhe kjo vlen edhe për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, mendoj se është perspektiva evropiane, motivi kryesor dhe në këtë drejtim unë mund t'i inkurajoj të gjithë përgjegjësit politikë që t'i kthehen punës parlamentare. Është detyrë e qeverisë që t'i afrohet opozitës dhe detyrë e opozitës që të vetëpërfshihet në mënyrë konstruktive, kritike, por edhe të angazhuar. Kemi të bëjmë edhe me imazhin që jep Shqipëria në planin ndërkombëtar", tha z. Hahn.

Meta, mesazh politikanëve: Të bashkohemi për Shqipëri të begatë!

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, zhvilloi dje një takim me një grup fëmijësh të shkollës 9-vjeçare "Skënder Çaçi", në Tiranë. Përmes një mesazhi në rrjetet sociale, kreu i shtetit thekson se kjo vizitë i ka zbuluar ditën dhe në kryeqytet. Ndër të tjera, Meta përcjell edhe një mesazh për gjithë politikën shqiptare, teksa shprehet se duhet të punojnë të gjithë së bashku për një Shqipëri më të begatë dhe më të bashkuar. "Vizita e një grupi fëmijësh të shkollës 9-vjeçare 'Skënder Çaçi' në Tiranë ma zbuloi ditën. Shkëlqimi në sytë e tyre më zëvendësoi diellin e munguar këto ditë në kryeqytet, ndërsa pyetjet e tyre të mençura e befusuese, më rritën shpresën për të ardhmen e ndritur të kombit tonë! Të mbështemi fort në ëndrrat dhe çiltërsinë e fëmijëve, për të punuar të gjithë bashkë për një Shqipëri më të begatë e më të bashkuar", shkruan Meta.



pro-amerikan. Sa i takon dhunën, sigurisht dënoj çdo lloj dhune. LSI-ja nuk ka problem goditjen e institucioneve. Qëllimi i LSI-së është që të pushtojë zemrat e shqiptarëve. Ajo që ne duam është që Shqipëria të ecë përpara", tha zj.Kryemadhi. Kryetarja e LSI shtoi se për situatën aktuale të vendit, përgjegjëse është e gjithë klasa politike, duke përfshirë edhe veten. "E gjithë klasa politike është shaktare e kësaj situatë. Kemi mbyllur sytë dhe gojën disa herë. Sot në radhë të parë duhet të heqim dorë nga pushteti.

Flasim për korrupsionin, por nuk flasin për një tjetër rrezik: mbetja jashtë projektit të BE-së. Nëse mbetemi të fundit me Kosovën dhe Bosnjën, do të thotë t'i varësh mëlcitë dukut në qafë, duke sjellë edhe rrezikun e ndikimit rus në Ballkan", deklaroi kryetarja

e LSI. Kryemadhi, e pyetur nëse mund të konfirmojë se ish-kreu të grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, i është refuzuar viza nga SHBA-të, u përgjigj se nuk e beson një gjë të tillë. Kryemadhi tha se sipas saj, Vasili është njeriu më pa probleme,

por shtoi se nuk e vë dorën në zjarr as për fëmijët e saj, as për bashkëshortin. "Jo, nuk besoj që i është refuzuar viza zotit Vasili. Nëse ka një njeri më pa probleme është Vasili, por nuk e vë dorën në zjarr as për fëmijët e mi, as për bashkëshortin tim. Por

në çdo rast, çdo ndarje informacioni në raste të tilla me ambasadën amerikane dhe me LSI do të jemi të gatshëm. Por, të mos harrojmë se Vasili ka qenë një ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë të Lu për reformën në drejtësi", theksoi zj.Kryemadhi.

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA:
Shteti ankandin, faza II, për shiten e pasurisë së paluajtshme për të cilat ka vene hipoteke NBG BANK/ AIBI BANK, me këto të dhëna:
- "Ara", me sipërfaqe 5,130 m², me adresë në Piraj, Lezhë, ne Zonën Kadastrale Nr. 2364, me Nr. Pasurisë 2019/V, Vol. 1, fq. 127, në pronësi të znj. Alma Luigj Marku,
Në vlerën 1,736,000 (një milion e shtatëqind e tridjetë e gjashtë mijë) Lekë.
"Njësi", me sipërfaqe 191 m², me adresë në Lagjen "Basilidhpi", Lezhë, ne Regjistrin hipotekor Nr. 578, date 28.10.2016, ne Zonën Kadastrale Nr. 8632, me Nr. Pasurisë 4/400-N11, në pronësi të Shoqëria ENCO GROUP sh.p.k
Në vlerën 75,040 (shtatëdhjetë e pesë mijë e dyzetë) EUR.
Ankandi zhvillohet në datën 14.06.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbarësuesit gjyqësor, me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA:
Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë , për shiten e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vene hipoteke ALPHA BANK, me këto të dhëna:
Apartament me nr.pas.7/21+1-4 , zk.8360, vol.26 , fq. 204, me sip 138.40 m2, Rruga "Zenei Baboci" Tiranë, në pronësi të z.Gentian Kujtim TOSKU.
Cmimi me të cilin fillon ankandi është 124.006 Euro (njëqind e njëzetë e katër mijë e gjashtë eur).
Ankandi zhvillohet në datën 30.05.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbarësuesit gjyqësor me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.

PD dhe LSI çojnë anëtarët e tyre në komisionet e administrimit të zgjedhjeve

PD me komisionerë për 30 qershorin, Bardhi: Po kryhen manipulime

"Dokumentim i paligjshmërisë që Rama po bën me zgjedhjet"



Valentina Madani

Opozita akuzon se qeveria ka nisur që tani manipulimin e zgjedhjeve me regjistrimin e paligjshëm të kandidatëve për kryetar bashkie. Përballë kësaj situatë, PD dhe LSI "mund të shfrytëzojnë ligjin, për të dërguar anëtarët që i takojnë në KZAZ, sipas tyre, për të provuar ligjërisht që Edi Rama nuk garanton zgjedhje legjitime".



Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike, Gazment Bardhi

EDI PALOKA
"Anëtarët e KZAZ-ve do të jenë për të ndaluar manipulimin e zgjedhjeve. E gënjën mendja Edi Ramën, nëse mendon se do ta lëmë të bëjë çfarë të dojë, qoftë edhe me këtë proces fals. Kompleksi për të mos u dukur vetëm në zgjedhje dhe me qëllim për të manipuluar ndërkombëtarët, Rama po deligjitimon vetë procesin, duke emëruar rivalë për 30 qershorin", tha z.Paloka.

MANIPULIMI

Për të dokumentuar dhe çmontuar këtë paligjshmëri, PD dhe LSI mund të shfrytëzojnë ligjin për të dërguar anëtarët që i takojnë në KZAZ, për të provuar ligjërisht që Edi Rama nuk garanton zgjedhje legjitime, edhe kur nuk ka kundërshtarë përballë. Në ditët në vijim do të faktojmë të gjitha paligjshmëritë e kryera nga përfaqësuesit e Ramës gjatë procesit", - tha z.Bardhi.



Lirohen protestuesit, Noka paralajmëron oficerët: Do të përgjigjeni

Gjkata e Tiranës liroi dje 7 protestues që morën pjesë në protestën e 13 majit. Gjykata vendosi 5 masa detyrim paraqitje dhe 2 masa arrest shtëpie. Masa detyrim paraqitje është dhënë për Arelin Ndocin, Beb Ndrekin, Besmir Pulën, Panajot Mirakën dhe Albi Gerbën. Ndërsa masa arrest shtëpie për Dritan Kukën dhe Qazim Nazerën. Akuzat që rëndojnë ndaj tyre janë "Kundërshtim i policisë me dhunë", "Shkatërrim prone" dhe "Prishje e qetësisë publike". Të arrestuarit thanë para gjykatës se gjatë arrestimit i ndaj tyre ishte ushtruar dhunë. Në lidhje me këtë vendim reagoi ish-deputeti Flamur Noka. Sipas Nokës, burgosja e protestuesve ishte politike, u urdhërua nga Edi Rama, kurse premtori se kur opozita të vijë në pushtet, ata që kanë burgosur protestuesit me prova të fabrikuara do të mbajnë përgjegjësi. "Një ditë drejtësia do të veprojë, opozita mban shënim çdo gjë. Dita e gjykimit për oficerët e policisë që fabrikonë prova do të vijë, për ata që nuk i shërbejnë shtetit dhe ligjit, por krimin dhe pushtetit. Ata do të japin llogari, sepse të fabrikosh prova është krim", tha Noka. Po dje policia arrestoi një tjetër protestues nga Tropoja, për ushtrim dhune në protestë.

Mision vëzhgues, OSBE-së nis punën për zgjedhjet e 30 qershorit

Zyra e OSBE-së për Instituton Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) shpalli dje thirrjen për vëzhgues në zgjedhjet lokale të Shqipërisë, që do të mbahen më 30 qershor. Kjo zyrë është agjencia udhëheqëse në Evropë në fushën e vëzhgimit të zgjedhjeve dhe thirrja e tyre për vëzhgues në procesin zgjedhor vjen në një kohë kur opozita joparlamentare shprehet se nuk do të lejojë të kryhen këto zgjedhje. ODIHR koordinon dhe organizon vendosjen e misioneve të shumta vëzhgues me mijëra vëzhgues çdo vit, për të vlerësuar përputhjen e zgjedhjeve në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike dhe legjislacionin kombëtar. Metodologjia unike e ODIHR-it ofron njohuri të thella në të gjitha elementet e një procesi zgjedhor, duke lejuar zyrën të ofrojë rekomandime konkrete për të përmirësuar më tej proceset zgjedhore. Pas një ftese zyrtare për të vëzhguar zgjedhjet lokale të planifikuara për 30 qershor 2019, ODIHR po përgatitet të vendosë një Mision Vëzhgues Zgjedhor (ZKM) për këto zgjedhje. Në këtë drejtim, ODIHR-i po kërkon të rekrutojë staf mbështetës lokal për pozicionet e përmendura me orar të plotë.



cesit zgjedhor, prandaj kanë porositur degët që të propozojnë anëtarë në këto komisione. Në një reagim pas interesimit të medias lidhur me porosinë drejtuar degëve për propozimin e anëtarëve që i takojnë PD-së në KZAZ, Bardhi sqaroi se partitë opozitare kanë informacion zyrtar se në KZAZ janë duke

u kryer manipulime të rënda të procesit zgjedhor, që nis me regjistrim të paligjshëm të kandidatëve për kryetar bashkie. Sipas Bardhit, kjo bëhet për të dokumentuar paligjshmërinë që sipas PD-së, Edi Rama po bën me zgjedhjet. "Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim kanë informa-

cion zyrtar se në KZAZ janë duke u kryer manipulime të rënda të procesit zgjedhor, që nis me regjistrim të paligjshëm të kandidatëve për kryetar bashkie. Për këtë arsye, për të dokumentuar dhe çmontuar këtë paligjshmëri, PD dhe LSI mund të shfrytëzojnë ligjin, për të dërguar anëtarët që u takojnë në KZAZ, për të provuar ligjërisht që Edi Rama nuk garanton zgjedhje legjitime, edhe kur nuk ka kundërshtarë përballë. Në ditët në vijim do të faktojmë të gjitha paligjshmëritë e kryera nga përfaqësuesit e Edi Ramës gjatë procesit", thuhet në reagimin e Bardhit. Protesta e ardhshme kombëtare e opozitës do mbahet pasditën e të shtunës së 25 majit. Vendimi u mor pas një të mërkure intensive konsultimesh në selinë blu me aleatët, ish-grupin parlamentar e kryesinë e PD. "Tani që na ndajmë 45 ditë nga 30 qershori, çfarë do të ndodhë? Do të pranohet që grushti i shtetit të çohet deri në fund dhe në Shqipëri të instalohet tirania e krimit në të gjitha nivelet? Sepse kjo jo vetëm do të instalonte tiraninë e krimit në pushtetin vendor, por do të çimentonte edhe tiraninë e krimit në qeverisjen qendrore. Apo do të ketë një përballje totale popullore për ta mposhtur me të gjitha mjetet dhe format e tjera, tiraninë e krimit", deklaroi z.Basha.

SHPLLJE ANKANDI
Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me Përmbarues Gjyqësor Enuar Merko me adresë, Rruga Ibrahim Rugovës, Pallati 64, Hyja 8, Apartamenti 1, Tiranë, njofton se më datë 07.06.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandit III - të për shlyerje e pasurisë së palajshme, Trural me sipërfaqe totale 3104 m², regjistruar në Z.V.R.P.P.Durrës, me Nr.pasurie 16/31, Volumi 11, Faqe 10, Zona Kadastrale 8516, në pronësi të Shoqërisë "ADRIATIKA BETON" sh.p.k. me vlerë fillestare në ankand 225.971.2 (Dyqind e njëzet e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjet e një mijë dy) Euro.
Të interesuarit të kontaktojnë në nr.e telefonit 0672027580, + 355 4 22 31 888. email enuar.merko

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përmbarimore "Best 2019"
SHPLLJE ANKANDIT TE DYTE
Më datë 06 qershor 2019 nga ora 08.00-ora 16.00 i ka kjo zyra përmbarimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së detyrues për ankandit e II të për shlyerje e pasurisë: 019/2018/116, vol.51, nr.242, sip-tz me 30 ligje shtetëror nr.24/18, NRZ, vol.56, fq.121, sip-20m/ c) nr.26/187-1-9, vol.52, fq.58 (sip-110 m²), d)nr.26/106-1-25, vol.52, fq.1
Cmimi fillestar (për pasuritë e largpamendura) për njësi e shërbimi do të jetë 1120 euro/m², ndërsa për tre apartamente do të jetë 252 euro/m².
Prona e largpamendura ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vore) që ka ndërtuar Dëbtori "CO BE Mirajak (OJUS 3/2017/8).
P.s. Detyruesitshlyesit që deshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të cmimit fillestar si garancë për pjesëmarrje në ankand. Kjo garancë pasurore duhet të jetë e dorëzuar në BKT, nr.llogarise Samiri Hotia PF (IBAN: ALUT 2051 2046 4204 9002 PRCLJALIA).
Me adresë : Selia, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës, Mobil: 06920 756 44, Pnoli/Fax: 052 22 6000. Web: <http://www.permbarues.al>

NJOFTIM ANKANDI
Shoqëria e Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të I-rë, për shlyerje e pasurisë ARE, me sip. 1045 m². Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 319/24, Vol. 1, Faqe 220, ndodhur në Fier-Shegan Lushnjë, në pronësi të: z. Bajram Selfer Skiraj, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandit i pasurisë fillestare me çmimin fillestar në vlerën **835,000 (tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) LEKË**.
Ankandit do të zhvillohet më datë 22.05.2019, ora 16.00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042520227, email: gnyn@btsmail.com.
Publikimi i njoftimit të ankandit të filloj me date 17.05.2018 deri me date 21.05.2019.

TIRANË - Gjykata e Tiranës ka lënë të lirë një prej të arrestuarve për vrasjen e 41-vjeçarit Devi Kasmi, në janar të vitit 2018. Mario Meshini u arrestua nën dyshimin se ka nxjerrë nga shtëpia Kasmin, ai u vu në pranga në shtëpinë e tij, pa bërë rezistencë. Emri i të riut u zbulua pas verifikimit të thirrjeve dhe mesazheve telefonike në telefonin e Kasmit. Mirëpo, pas



Ekzekutimi i Devi Kasmit, gjykata e Tiranës liron pas më shumë se një viti Mario Meshinin

disa muajsh qëndrimi në qeli, Gjykata e Tiranës vendosi ditën e djeshme që të lërë në fuqi masën e sigurisë "detyrim paraqitjeje". Mbi Meshinin rëndonte akuza e moskallëzimit të krimit. Devi Kasmi u qëllua disa herë me pistoletë

në kokë dhe trup, ndërsa policia dyshon se porositës i vrasjes së tij është Domart Konjari, i cili kërkohet nga autoritetet shqiptare, por edhe ato franceze. Vrasja ka dyshime se ndodhi për prishje të pazareve të kokainës në

Francë dhe Spanjë. Edhe gjatë kontrollit të banesës së Kasmit u gjet 3 kg kokainë, 300 gr drogë LSD dhe një armë automatike. Grupi i të arrestuarve për vrasjen e Devi Kasmit i ka kaluar Gjykatës së Krimeve të Rën-

da, pasi ajo e Tiranës e cilësoi si një grup të strukturuar kriminal. Devi Kasmi u vra më 29 janar të këtij viti në derën e shtëpisë së tij. Ai u qëllua disa herë me pistoletë në kokë dhe trup. Si ekzekutues është i pandehur shtetasi grek Eftimiu Eftimius, 49 vjeç, i cili nuk ka pranuar krimin, duke pretenduar se kishte ardhur në Tiranë për pushime.

Djemtë përkulen para të atit. Kuvendi mban një minutë heshtje për 'Dëshmorin e Atdheut'

Shqipëria në zi, përcillet me lot, dhimbje dhe nderim të thellë major Klodian Tanushi

*Përlotet ministrja Xhaçka: "Do jemi pranë familjes".
Gjeneral Kollçaku: Lamtumirë vëllai ynë!*

TIRANË
Me dhimbje dhe lot u përcoll dje në banesën e fundit major Klodian Tanushi, i cili humbi jetën si pasojë e shpërthimit të një mine në kamp Adazi në Letoni. Homazhet për dëshmorin më të ri të atdheut u mbajtën në Muzeun Kombëtar. Para arkmortit u përlotën në nderime, familjarët, miqtë e kolegët e komandant Tanushit. Pranë tij për herë të fundit ishte dhe rreshteri Julian Kapaj, i cili mbeti i plagosur nga shpërthimi i minës. Pas apelit të fundit dhe një minute heshtje, familjarë, të afërm e miq, por edhe personalitetet të larta shtetërore i dhanë lamtumirën e fundit 39-vjeçarit të rinë në krye të detyrës. Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, kryeministri Edi Rama, ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, si deputetë e ish-ministra si dhe kryebashkiaku Erjon Veliaj bënë homazhe dhe u përkulën djme në nderim para trupit të major Klodian Tanushit. Homazhe për nder të majorit Klodian Tanushi, kreu edhe numri dy i partisë demokratike, Edi Paloka si edhe ish-deputeti demokrat, Edmon Spaho. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, ka shpërthyer në lot, teksa i ka dhënë mesazhin e lamtumirës major Klodian Tanushit. Gjatë fjalës së saj para familjarëve, ministrja është shprehur se major Tanushi iu ka lënë një boshllëk të madh gjithë familjarëve, por edhe kolegëve e vetë ministres. Ndër të tjerë, Xhaçka ka zbuluar dhe amanetin e fundit të Tanushit. "Fatkeqësisht dhimbja na u shtua përsëri, pas vdekjes së Zariife Hasanajt. Ndarja nga jeta e major Klodian Tanushit është aq e



Dy djemtë e majorit gjatë homazheve

rëndë dhe aq e trishtueshme, sa është e vështirë të gesh fjalët e duhura për të qetësuar sado pak zemrat e familjarëve. Edhe pse

mirënjohja dhe krenaria është pa kufi, sërish nuk mund ta zbusim zemrën e bërë gurë të familjarëve të tij. Jemi pranë tyre. Është

shumë e dhimbshme edhe për mua që e kam njohur nga afër këtë ushtarak dhe që besoj se do ia dilte mbanë. Ai nuk ia doli duke na lënë një boshllëk të madh bashkë me humbjen e paktëshme. Majori e përmbyshi me krenari misionin e tij, duke sakrifikuar jetën. Majori na la amanetin e fundit "mbi interesat vetjake, të vëmë interesat e gjithë Shqipërisë". Prehu në paqe të përjetshme heroi ynë, dëshmorin më të ri i Atdheut", tha Xhaçka. Ndërkohë, Gjeneral Brigadë Bardhyl Kollçaku në fjalën e mbajtur në lamtumirën e major Klodian Tanushit tha se punën dhe profesionalizmin e tij, do ta kujtojnë çdo ushtar dhe koleg i tij. Me zërin që i dridhej, Kollçaku tha se FA-ja ka humbur një komandant të palodhur. Teksa mbajti



Ceremonia e lamtumirës së major Klodian Tanushit

fjalën dhe me lot në sy para familjes, ai shtoi se major Klodian Tanushi i shtoi nderin Shqipërisë nga puna e tij, e cila tashmë do të nderohet nga çdo qytetar i këtij vendi. Ndërkohë, me kërkesë të kreu të grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi i ndërpreu fjalën deputetes Antoneta Dhima për të mbajtur një minutë hesh-

je në nder të major Klodian Tanushit, i cili humbi jetën në krye të detyrës me misionin e NATO-s në Letoni. "Për të nderuar jetën e major Tanushit, ftoj të mbajmë një minutë heshtje. U prehtë në paqe major Tanushi", tha Ruçi. Major Tanushi u plagos me 6 maj në kampin ushtarak "Adazi" dhe katër ditë me vonë humbi jetën në spital si pasojë e plagëve të marra.

Lamtumirë "Dëshmorin e Atdheut"! Rama, mesazh 3 fëmijëve të majorit

TIRANË - Kryeministri Edi Rama teksa mbajti fjalën në lamtumirën e fundit të major Klodian Tanushit tha se komandanti dha jetën për të genë në anë e duhur të historisë. Ai dha dje një mesazh për tre fëmijët e majorit, ku shtoi se nuk ka gjë më të shtrenjtë se sa të kujtohesh për fjalën dhe veprën e mirë që ka lënë pas babai i tyre. "Ata na tregojnë se bashkimi ka një vlerë. Ata na tregojnë se është një kohë vendimtare për të ardhmen tonë "dielli i shqiptarëve" lind gjithmonë nga perëndimi. Një tjetër dëshmor nga FA do të shkojë sot tek "Nëna Shqipëri" dhe nuk është e pamundur, por e natyrshme të bëhet lidhja e atyre që janë simbol i një lufte heroike dhe Zariife apo Klodianit, që iu bashkohen në banesën e fundit si pjesë e një historie të re, që kërkon sakrificë të reja në një vend që i përket NATO. Të dyja palët i bashkon ana e duhur e historisë, dëshmorët e luftës, janë dëshmorët e një përpjekje kombëtare në anë e duhur të historisë, por edhe dëshmorët e rinj janë në anë e duhur të historisë. Të jesh sot në krah të SHBA dhe vendeve të tjera të NATO-s do të thotë të japësh jetën duke qëndruar në anën e drejtë të historisë", tha Rama. Ndërsa, ndër të tjerë u shpreh se "ky është një vend i vogël, por përtej kontributeve financiare dhe njerëzore, por të gjitha kanë në NATO një kontribut, që nuk mund të matet në mënyrë sasiore dhe na bën të gjithëve të barabartë, kontributi i gjakut. Qoftë i përjetshëm kujtimi dhe një fjalë për tre fëmijët: Një ditë kur ju të bëhemi prindër do të keni kuptuar përfundimisht atë që babai i juaj ju ka lënë sot shënim në zemrat tuaja, se asgjë më shumë në këtë jetë nuk vlen se emri dhe kujtimi i mirë".



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,840,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Haliili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktëshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfuttes: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 10 Qershor 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Reagon policia: U gjet i shtrirë me fraktura në kokë...

Denoncimi i Berishës: Policia fshehu rrahjen me pasojë vdekjen e 50-vjeçarit

TIRANË - Ish-kryeministri Sali Berisha ka denoncuar vdekjen e një qytetari në Vlorë. Teksa ka publikuar mesazhin e qytetari dixhital, Berisha shkruan se kjo ngjarje u fsheh nga policia, pasi sipas tij, shkatërrat dhe përgjegjësit e vërtetë janë bandat e Partisë Socialiste.

POSTIMI I BERISHËS
"Fshihet nga narkopolicia krimi i shëmtuar,

rrahja me pasojë vdekjen e qytetarit në Vlorë! Miq, fshehja e krimeve tipar i narkopolicisë së Vasal Kimikut dhe Edvin Mashtimit! Miq, çdo ditë qytetarët denoncojnë narkopolicinë për fshehje të krimeve. Shkaku kryesor i këtij qëndrimi kriminal është sepse narkos me uniformë janë autorë të tyre ose krimet janë kryer nga bandat e partisë! Lexoni mesazhin e qytetarit dixhital. sb

Doktor të përshëndes
Një qytetar me emrin Alfred Deliaj rreth 50 vjeç, para 3 ditësh u gjend në Sheshin e Flamurit i rrahur me fraktura në kokë. Sot ndërroi jetë. Familjarëve në fillim u tha që ishte aksident, më pas nuk thanë më asgjë. Askush nuk e raportoi nga mediat, apo komunikatë nga policia e shtetit. Terrinformativ verifikojeni. Të uroj shëndet", thuhet në mesazh. Ndërkaq, në lidhje



me këtë ngjarje ka reaguar policia e Vlorës, e cila deklaruar se personi për të cilin bëhet fjalë u gjet i shtrirë me fraktura në kokë. Më datë 12.05.2019, në "Sheshin e Flamurit" është

gjetur i shtrirë në tokë (nën efektin e pijeve alkoolike) shtetasi A.D., 47 vjeç, banues në Vlorë, me frakturë në kokë. Nga këqyrja paraprake në trupin e tij nuk janë vërejtur shenja dhune apo dëmtime të tjera përveç frakturës që ka marrë në kokë, dyshohet për shkak të rrëzimit. Ky shtetas ka ndërruar jetë 3 ditë më vonë në spital dhe sipas aktit të ekspertizës rezultuan se vdekja ka ardhur për shkak të hemorragjisë cerebrale në kokë. Policia i ka referuar materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për veprime të mëtejshme.

SHKURT

Sekuestrohen 205 kg kanabis sativa në Mal të Zi, vinte nga Shqipëria

MALI I ZI - Një sasi e konsiderueshme lëndë narkotike është sekuestruar nga policia e vendit fqinj. Kështu, policia malazeze, në afërsi të lumit Buna, në vendin e quajtur Sutjel në territorin e Komunes së Ulqinit, ka bërë të mundur sekuestrimin e rreth 7 çantave me 205 kg lëndë narkotike kanabis, të cilat u gjetën rreth 130 metra larg bregut të lumit. Sipas informacioneve të policisë malazeze sektori i policisë kufitare, gjatë patrullimit të kufirit mes Shqipërisë dhe Malit të Zi në afërsi të Lumit Buna, janë pikasur 4 persona të cilët po transportonin çantat. Pasi janë parë nga policia, ato janë larguar. Dyshohet se lënda narkotike ka ardhur nga Shqipëria dhe kishte destinacion Main e Zi. Ndërkohë, po punohet në kapjen dhe identifikimin e transportuesve, por edhe të bashkëpunëtorëve të trafikantëve nga Shqipëria me ata malazezë.

Zhdukjet nëna shqiptare bashkë me vajzën, alarmohet policia

ANGLI - Një nënë shqiptare dhe vajza e saj vetëm 2 vjeçe, janë zhdukur pa lënë asnjë gjurmë në Mbretërinë e Bashkuar. Sipas "BBC", Sebjana Myzeqari dhe vajza Enisa janë parë për herë të fundit në Doncaster më 2 prill. Mësohet se Sebjana nuk ka përdorur as telefonin dhe as kartat bankare, madje nuk rezultoi që të jetë larguar nga Mbretëria e Bashkuar. Burime pranë policisë janë shprehur "të shqetësuar" për sigurinë e nënës dhe vajzës. Oficeri Neil Thomas deklaroi se "zonja Myzeqari është zhvendosur para tre vitesh në Doncaster dhe vogëlushja ishte e regjistruar në çerdhe". Sipas oficerit, zonja Myzeqari jetonte një jetë të izoluar dhe kishte pak miq në qytet. Madje ata kanë kërkuar ndihmën e autoritetit shqiptar, por nuk rezultojnë gjurmë të tyre as në Shqipëri. "Ne jemi shumë të shqetësuar. Fakti është që nëna 24-vjeçare dhe vajza e saj dyvjeçare rezultojnë të zhdukura nga faqja e dheut dhe askush nuk i ka parë ato", u shpreh oficeri. Policia u ka kërkuar të gjithë qytetarëve që kanë informacion rreth tyre të kontaktojnë numrin 101.

Kryen 9-të grabitje me armë, zbulohet e shkatërrohet banda e shqiptarëve në Greqi

Operacioni në Athinë, Kaisariani e Artemis, u arrestuan 6 persona

GREQI

Një bandë shqiptare që sistematikisht kryente plaçkitje me armë në pikat e karburantit, në objektet private në parkimin e makinave dhe të shtëpive në pjesë të ndryshme të Atikës është zbuluar dhe shkatërruar nga policia greke. Për rrjedhojë pas një operacioni policor të organizuar në Athinë, Kaisariani, Nea Ionia Acharnes dhe Artemis u arrestuan gjashtë anëtarë të grupit, të moshës mes 22 dhe 41 vjeç, të cilët, sipas policisë, kanë kryer më shumë se nëntë plaçkitje me armë dhe një vjedhje. Ata akuzohen për krijim organizate kriminale që kryen plaçkitje dhe vjedhje të rënda në bashkëpunim dhe në mënyrë të përsëritur, si dhe për trafik droge dhe armëmbajtje pa leje.



Armët dhe materialet e sekuestruara gjatë operacionit

DROGA
Policia greke ka sekuestruar dje mbi 26 kg marijuanë në kufirin greko-shqiptar. Ky operacion është zhvilluar në Kallpaq, në aksin Kavajë-Janinë. Mësohet se policia ka ndaluar mjetin që drejtohej nga një grek 56 vjeç dhe ka sekuestruar brenda tij 3 pako me 26 kg 600 gr marijuanë, të cilat ishin ngarkuar në kufirin e gjelbër. Në pranga ra drejtuesi i mjetit, ndërkohë që u sekuestruan 2 celularë, 250 euro dhe një pajisje GPS.

çelësat e tyre të mbajtura në zyrat e këtyre vendeve parkimi. Mjetet e vjedhura pastaj i përdornin si mjete transporti për të kryer krime të tjera. Autorët vepronin me maska, ndërsa për komunikimet e tyre të ndërsjella përdornin telefona celularë dhe

karta SIM të regjistruara në emra personash jo ekzistente. Nga hetimet e policisë dhe nga kontrollt e kryera në shtëpitë e të pandehurve dhe në vende të ndryshme, janë gjetur dhe konfiskuar, ndër të tjera: Një kallashnikov, pushkë sulmi me karikator dhe 30 fishekë, dy pistoletë me karikatorë të mbushur si dhe 5 fishekë, një revolvër me 20 fishekë, 1.100 gr kanabis si dhe katër vetura private. Deri më tani, janë zbuluar gjashtë grabitje në stacionet e shërbimit, 2 në mjediset e parkimit privat, një grabitje në shtëpi dhe një vjedhje me motor. Përveç kësaj, për një 31-vjeçar të arrestuar pjesë e këtij grupi, rëndojnë pesë vepra si: vrasje me qëllim, konspiracion, grabitje, vjedhje, armëmbajtje dhe pa leje dhe ekspozivë ndërkohë që ka edhe dy urdhër-arreste për konspiracion, grabitje dhe trafik droge. Gjithashtu, për një 30-vjeçar edhe ky pjesë e grupit ka një urdhër arresti për konspiracion, grabitje, vjedhje dhe nërëmbim personi. Të arrestuarit dhe dosja në ngarkim të të arrestuarve shqiptarë është dërguar në Prokurorinë e Athinës dhe do të vazhdojnë hetimet për përfshirjen e tyre edhe në krime të tjera të ngjashme.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,000,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallit", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 10 Qershor 2019, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Gjykata urdhëron që 5 parcelat e tokës objekt shqyrtimi të kalojnë në pronësinë e shtetit

Falsifikuan pronat në plazhin e Spillesë, dënohen ish-kreu i hipotekës dhe 8 zyrtarë

Vendimi, 18 vjet burg ndaj personave të akuzuar

KAVAJË

Gjykata e Kavajës shpalli fajtorë nëntë zyrtarë lokalë dhe i dënoi ata me 18 vjet burg për tjetërsimin e pronave në plazhin e Spillesë. Sipas vendimit të shpallur në prill nga gjyqtari Rexhep Bekteshi, ish-zyrtarët e Hipotekës dhe njësi administrative në Kavajë kanë përfutur uljen e 1/3 së dënimit për shkak të gjykimin të shkurtuar.

Gjykata e Kavajës urdhëron, gjithashtu, që 5 parcelat e tokës objekt shqyrtimi të kalojnë në pronësinë e shtetit. Sipas hetimeve 2-vjeçare të Prokurorisë, ish-zyrtarët janë përgjegjës për falsifikimin e dokumenteve që mundësuan tjetërsimin e pronave publike në bregdet, fillimisht në emër të banorëve të zonës dhe më pas tek të afërmit e drejtuesve të pushtetit lokal, përfshirë ish-kryetarin e Bashkisë, Elvis Roshi.

Hetimi për tjetërsimin e 36 hektarëve tokë në bregdetin e Kavajës u finalizua në nëntor 2017 me arrestimin e 11 personave. Urdhër-arrest u lëshua edhe ndaj shefit lokal të Hipotekës, Seid Cikalleshi. Hetimet zbuluan skemën e tjetërsimit, e cila kishte transferuar 36 ha pronë publike në bregdet përmes shit-blerjeve të dyshimta.

Çështja u dërgua fillimisht për gjykim nga Prokuroria e Kavajës në shkurt të vitit 2018, por në një seancë paraprake të zhvilluar në korrik 2018, Gjykata e Kavajës e ktheu atë pas për hetime të mëtejshme.

Dosja e falsifikimeve u dërgua për herë të dytë në gjykatë në fillim të vitit 2019; ku u vendos nisja e shqyrtimit gjyqësor. Me vendimin e shpallur në prill, gjykata e Kavajës i ka gjetur fajtorë nëntë zyrtarë lokalë për skemën e tjetërsimit të pronave në plazhin e Spillesë. Ish-kryeregjistruesi i



Bregdeti i Spillesë

DËNIMET E PERSONAVE TË AKUZUAR

1. Seid Cikalleshi, ish-kreu i ZVRPP Kavajë dënohet me 2.8 vjet burg
2. Andi Gjeçi, jurist në ZVRPP Kavajë dënohet me 2.4 vite burgim
3. Asim Arkaxhiu dënohet me 2 vjet burgim
4. Aldo Kila dënohet me 1.8 vite burgim
5. Ilir Kaja i njësisë administrative Kryeviidh dënohet me 3 vjet burgim
6. Agron Xhelezi, ish-kryetar i Komisionit të Ndarjes së Tokave dënohet me 2 vjet burgim
7. Dritan Kazazi, ish-hartograf në ZVRPP dënohet me 2 vjet burgim
8. Nezir Leçini, ish-shef i Kadastrës dënohet me 2 vjet burgim
9. Aida Gjoci, 8 muaj burgim konvertuar në 120 orë punë të detyruar

Kavajës është dënuar me 2.8 vjet burg për falsifikim dokumentesh si dhe ndalim 2-vjeçar për ushtrimin e funksioneve publike. Dënime të ngjashme në aplikim të gjykimin të shkurtuar morën edhe 7 të pandehurit e tjerë, ndërkohe që dënimi për Aida Gjocin është konvertuar në punë të

detyruar pranë ndërmarrjes komunale të Kavajës. Falsifikimet e pronave në Kavajë janë vetëm një prej rasteve të hetuara vitet e fundit nga Prokuroria për abuzime masive me tokat publike. Prokuroria ka çuar në Gjykatë ose po heton çështje të ngjashme në Shkodër, Vlorë dhe Lezhë.

Një çështje e ngjashme po hotohet nga Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe ka të akuzuar ish-deputetin e Partisë Socialiste, Arben Ndoka, vëllain e tij dhe një sërë zyrtarësh lokalë, që akuzohen edhe tjetërsimin e sipërfaqeve të mëdha të tokës në bregdetin e Lezhës.

SHKURTE

Qëllonte veten me thikë brenda banesës, policia shpëton të riun

PATOS - Policia e Patosit është vënë në lëvizje në orët e para të mëngjesit të djeshëm, pasi një 35-vjeçar si pasojë e depresionit është mbyllur në katin e gjashtë të pallatit ku jeton, ndërsa ka qëlluar veten me thikë në pjesën e kraharorit. Bëhet fjalë për Neli Xhelaj, banues në këtë qytet. Menjëherë policia dhe ambulanca shkuan në vendin e ngjarjes dhe negociuan me 35-vjeçarin, i cili ishte mbyllur brenda banesës rreth orës 06:00. Pas afro katër orësh negociatash me të, i riu është nxjerrë nga banesa dhe është shpërndarë për të marrë ndihmën mjekësore. "Në datën 16.05.2019, rreth orës 09:00, në Patos, shtetasi L.Xh., (i cili dyshohet se vuan nga sëmundja mendore) pasi ka mbyllur derën e banesës nga brenda, ka tentuar të vetëvritet me një mjet prerës (thikë). Falë ndërhyrjes së forcave të policisë dhe FNSH Fier u bë i mundur neutralizimi dhe shoqërimi i tij drejt Spitalit Rajonal Fier ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën nën kujdesin e mjekëve", - njoftoi policia.

Dy shqiptarë vjedhin kamionin në Holandë, në pranga një prej tyre

HOLANDË - Nuk ka zgjatur shumë aventura e dy shqiptarëve në Holandë, të cilët mundën të vidhnin një kamion, por u pikasën nga policia. Në ndjekje të tyre, ata janë përplasur me policinë. Ngjarja ka ndodhur mëngjesin e djeshëm në autostradën A67, kur dy shqiptarët kanë vjedhur kamionin dhe kanë tentuar t'i shpëtojnë policisë. Pasi autoritetet vunë re se diçka nuk shkonte me kamionin, i kërkuan shqiptarëve që të ndalnin për kontroll, por ata u larguan me shpejtësi. Menjëherë oficerët janë vënë në ndjekje të tyre, teksa shqiptarët kanë ecur për një distancë dhe më pas kanë ndalur kamionin duke u përpjekur të largohen. Policia ka qëlluar në ajër, për t'i paralajmëruar shqiptarët dhe kanë mundur të arrestojnë njërin prej tyre, ndërsa tjetri është larguar. Sipas policisë, dyshohet se njëra makinë tjetër ishte e përfshirë në vjedhje. Në të ishin pesë persona, pjesë e një grupi të organizuar për vjedhje mallrash në Holandë.

United Nations Development Programme



VACANCY ANNOUNCEMENT

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancy.

1- Post Title: Project Coordinator
2- Post Title: Project Assistant
Deadline for application: 23 May 2019
Type of Contract: Service Contract
Project: Support to RYCO
Duty Station: Tirana, Albania
Duration of Assignment: 1 year with possibility of extension

Job Description: <http://al.undp.org>
 Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>. Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.

INTERNATIONAL CONSULTING COMPANY IS LOOKING FOR

► **1 (one) Expert on Trade** (E.U. Category II) with special focus on trade in goods, trade facilitation, involvement of private stakeholders in technical level discussions

► **Qualifications and Skills**

- Master's degree or equivalent, preferably in economics, trade, or in areas related to trade policy development and reform.
- Not less than 6 years of experience, of relevant professional experience in the field of economic and trade policies
- At least 3 years of experience on issues related to CEFTA, WTO, GATT with background on trade in goods, trade facilitation, and private sector involvement in technical discussions
- Experience related to management of at least one EU or other donor funded action/project
- Excellent writing and communication skills.
- Very good command of English,

► **1 (one) Expert on Trade** (E.U. Category III) with special focus on trade in services, trade facilitation, involvement of private stakeholders in technical level discussions

► **Qualifications and Skills**

- Master's degree or equivalent, preferably in economics, trade, or in areas related to trade policy development and reform.
- Not less than 3 years of relevant professional experience in the field of economic and trade policies
- At least 3 years of experience on issues related to CEFTA, WTO, GATT, with background on trade in services, trade facilitation and private sector involvement in technical discussions
- At least one year of experience in the implementation of an EU or other donor funded action/project
- Experience in facilitating the discussions on trade related policies/regional cooperation policies and strengthening economic cooperation within the region can be considered an asset
- Excellent writing and communication skills.
- Very good command of English, both written and spoken

Interested applicants might contact Mr. Marco Sessa at the following E-mail address: for further information: marco.sessa@sim-spa.it

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, shpërndahen tapitë dhe paratë e kompensimit

Ornela Manjani

Rreth 2 mijë persona që kanë ndërtuar pa leje do të marrin tapitë për truallin. Ndërkohë, 510 pronarëve të cilëve u është zënë toka nga këto ndërtime do të kompensohen. Vlera e parave që do të përndahet për përfituesit është rreth 230 milionë lekë. Vendimi është marrë këtë të mërkurë nga qeveria dhe do të zbatohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila do të pajisë me certifikatë pronësie 2 mijë përfituesit në 12 qarqe të vendit. Ndërkohë që fondi prej 230 milionë lekësh do të shpërndahet nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë me përfituesit e tapive dhe sipërfaqet takuese për secilin dhe

VKM, lista me 2 mijë pronarët që marrin tapitë

Kompensohen pronarët, 230 milionë lekë për 510 përfitues

listën me pronarët që kompensohen së bashku me shumën e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

VENDIMI

Qeveria miratoi kalimin e së drejtës së pronësisë në favor të subjekteve për-

fituese për 1205 parcela ndërtimore të objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre, ku përfillojnë rreth 2 mijë familje. Përfituesit janë në qarkun

Berat, Qarkun Elbasan, Qarkun Durrës, Qarkun Tiranë, Qarkun Fier, Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë, Kukës dhe Korçë. Sipas vendimit të qeverisë, masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të

paluajtshme që preken nga ndërtimet e legalizuara, referuar kartelave të pasurive sipas ZVRPP-së është 33 964,81 m² dhe vlera totale e kompensimit financiar është 229 092 338 lekë. Qeveria ngarkon zyrat ven-

dores të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, Elbasan, Librazhd, Durrës, Tiranë, Lushnjë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Kavajë dhe Kukës të regjistrojnë brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kalimin e së drejtës së pronësisë së parcelave ndërtimore dhe hipotekën ligjore mbi to, në përputhje me përcaktimet e pikave 15 e 16, të vendimit nr.1095, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara".

Nr. rëndor	Të dhënat e Pasurisë			Sipërfaqja e përbashkët
	Emër	Atësi	Mbiemër	
1	TAJAR	SAFET	HOXHA	320
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE				
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA				
2	FATMIR	ABEDIN	HYSI	215
3	AGIM	ISMAIL	GJEÇI	222
	HYRJE	SAMI	GJEÇI	
4	STEFAN	PETRAQ	KULE	51
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE				
5	GJEDRA SH.P.K			96.9
6	AGUR	ARMAND	ZYLI	274
	ARMAND	AGUR	ZYLI	
7	ILMI	HAXHI	DANUSHI	290
8	SYBI	ZENI	OLLDASHI	363
9	DRITAN	ENVER	DOLLANI	57.7
10	BRAHIM	REFAT	PULAKE	293
11	ALEKO	DHIMTER	BROÇI	60.4
12	LUAN	HATEM	KALEMI	141
	VITURI	REFAT	KALEMI	
13	DIAMAN	DANE	MELEQI	4.2
14	FATMIR	REFAT	BEJDO	386
15	ERALD	LILI	GARULI	60
16	BEKTAS	LIVAN	SHABANAJ	393
	LUMTUR	MYRTEZA	SHABANAJ	
17	GAZME	MUHAREM	LIKAJ	161
18	IDRIZ	NOVRUZ	SARACI	393
19	LUTIAN	HAJRI	DHELPRRA	115
20	DRITAN	ISMAIL	DAJA	264
21	BESNIK	ZYBER	AGALLIU	433
	SHPRESA	SHYQYRI	AGALLIU	
	ESTREF	NEKI	LLANGOZI	
	ASLLAN	HAKI	LLANGOZI	
22	SOKOL	SHABAN	TURHANI	500
23	GAZMIR	IBRAHIM	LUSHI	144
QARKU Berat, ZVRPP Ura Vajgurore, ZONA				
24	HATEM	HAIR	BAXHUA	145
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE				
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE				
26	REFAT	RAMADAN	GEQA	20
QARKU Berat, ZVRPP Kuçovë, ZONA				
27	Ismet	Safet	Hoxhallari	242

Nr. rëndor	Të dhënat e Pasurisë			Sipërfaqja e përbashkët
	Emër	Atësi	Mbiemër	
28	Aurel	Fatmir	Papa	84.8
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE				
29	Tajjar	Abdyl	Beqiraj	300
QARKU Berat, ZVRPP Kuçovë, ZONA				
30	Selami	Abdyl	Plaku	91.2
QARKU Berat, ZVRPP Çorovode, ZONA				
31	Ilir	Nehat	Kalluci	92
32	Mynyr	Refat	Bajraktari	280
33	Novrus	Refat	Bajraktari	321
QARKU BERAT, ZVRPP BERAT, ZONA				
34	SHEGË	IZET	ZEQAJ	16.2
	FLORESH	ZEQO	ZEQAJ	
	ARBEN	ZEQO	ZEQAJ	
	VULLNË	ZEQO	ZEQAJ	
QARKU BERAT, ZVRPP KUÇOVË, ZONA				
35	XHEVAI	HYSNI	SELAMAJ	360
DREJTORIA E ALUIZNI-T KAVAJË				
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8552,				
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1814,				
38	Ruzhdi	Hasan	Skuqi	393
DREJTORIA E ALUIZNI-T LEZHE				
QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA				
39	SOKOL	ZEF	GJERGJI	
40	BESNIK	MYFTAR	DULI	
41	GEZIM	MYFTAR	DULI	
QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA				
42	XHEMAL	VATH	HOXHA	325
QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA				
43	"IMS GROUP" SH.P.K			488.2
DREJTORIA E ALUIZNI-T TIRANA JUG				
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
44	HALIL	HAMEZ	HYSENAJ	370.5
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
45	ELMIHA	MEHMET	REXHEPI	238
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
46	AGRON	LUTFI	DISHA	240

Nr. rëndor	Të dhënat e Pasurisë			Sipërfaqja e përbashkët
	Emër	Atësi	Mbiemër	
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
DREJTORIA E ALUIZNI-T TIRANE (VERI)				
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8310, ZVRPP				
49	SHPRES	SADIK	NASUFI	170.2
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8320, ZVRPP				
50	BUJAR	TASIM	ALLKURTI	208
51	FERIT	RIZA	DAJTI	190.9
52	MIMOZA	ENVER	ZYBERAJ	260
53	ILMI	MURAT	BOSHKU	180
54	EDUART	HAKIK	SHQUTI	225
55	ALBI	SHYQYRI	DEMA	77.7
56	SHKELQI	IBRAHIM	GJOKA	129
57	SHEFQE	RAMAZAN	KURTI	500
58	NAIM	ALI	SINA	436.3
59	LORETA	KADRI	BEGANI	78.8
60	LORETA	KADRI	BEGANI	109.2
61	BAFTJA	HYSEN	CERA	281.4
62	RAMAZ	XHEVDET	BOSHKU	214.5
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8340, ZVRPP				
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8330, ZVRPP				
64	RAMAZAN	SALI	KALOSHI	270
DREJTORIA E ALUIZNI-T ZONAT TURISTIKE				
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA				
65	ALBANA GJON PREÇI			79.34
66	BRUNO LEC SHLLAKU			###
67	GJERGJ MARK LEKA			352
68	FATMIR HAJRULLAH TERLUA			155
69	NERXHIVAN XHEVDET GREZDA			###
70	GEZIM AHMET SALA			###
71	SAJMIR MUMTAZ VRIONI			315
72	GJOKE MARK LEKA			327.45
73	MARTIN MARK LEKA			473.37
74	MARTIN MARK LEKA			429.21

75	GJIN MARK ZHUJA			500
76	DOD MARK PRENGA			300
77	SABAH SAIT BIZI			78.75
78	KOL LULASH BUJARI			175.21
79	NIKOLLE FRAN NDREJAJ			346.4
81	ADHURIM ÇERCIZ BRAHIMLLARI YLLI ÇERCIZ BRAHIMLLARI			456.86
82	FLAMUR DUL KURTAJ			167
83	ILIR QAMIL ÇAKU			43.51
84	AGRON NDREK GURI			87.93
85	FATMIR SADIK HAXHIQ			43.3
86	RAGIP MADAN SHEGAJ			280.5
87	RAJMONDA OSMAN QOKTHI SKENDER			159.51
88	AGIM JAKUP DAUA			147
89	ANDRE A	GJIN	GJINI	115.32
90	MARIO	GJIN	GJINI	115.32
91	MARIO	ZEF	VATHI	151
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
DREJTORIA E ALUIZNI-T SHKODER				
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA				
94	TONIN	ZEF	LUKAJ	500
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA				
95	BERHAN	ABDULLAH	REXHA	500
96	ÇLIRIM	SABRI	IMERI	45.5
97	ERMAL ERMIR	PAL PAL	LEA LEA	268.4
98	BERHAN	ABDULLAH	REXHA	500
99	BARDHYL KOZETA	FADIL XHEVDET	TALANI TALANI	15.8
100	BESIM	ELEZ	ISUFJ	369
101	GEZIM	FEJZI	SHABA	65.2
QARKU Shkoder, ZONA KADASTRALE 3838, ZVRPP				
102	MUHO	ASHIM	BEJTJA	310
103	ALIM	YMER	ZYBERI	350
104	LUAN	SABRUSH	HARDHUA	500
QARKU SHKODER, ZVRPP MALESI E MADHE, ZONA				
105	SABRI	ZENEL	SEMANAJ	200
106	ZEPE	HAJDAR	HYSAJ	98.8
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA				
107	BERHAN	MET	TELI	206
108	GANI	CAF	AHMETI	58.1
109	FATMIR	DAN	NIÇERI	201
110	JAKUP	BEQIR	MANI	251
111	PAULIN	NDOC	GJERGJI	306
112	ARJET	RAMAZAN	MURLANI	201
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA				
113	RASIM	ALI	BEQIRI	375
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA				
114	AGIM	ISMAIL	QOSHJA	251
115	IBRAHIM	HYSE	SHABANAJ	188.3
116	BLENDI	TEOFIK	PIRANEJ	924
117	SAMIR	ISA	SHTALBI	320
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA				
118	KATRINE	ZEF	PREKA	500
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA				
119	ZEF	NDOC	MARKU	370
120	BESIM	CAN	ABDUA	355

121	YLBER	KASEM	KASEMI	205
122	HAZBI	SHYQYRI	DYLI	406
123	SHAQIR	SHYQYRI	DYLI	443
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA				
124	FAHRI	REXHEP	KADJA	500
125	PAL	NDUE	GALEJA	371
126	GJON	NIK	GURI	480
127	PAL	NDUE	GALEJA	371
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA				
128	AGIM	MUHARREM	HETOJA	355.8
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA				
129	ZYHRA	RAMAZAN	TIVARI	145
130	ARBEN	LATIF	TULA	380
DREJTORIA E ALUIZNI-T ELBASAN				
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA				
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA				
134	PETRIT	SALI	ÇEKINI	251.1
135	SAMIR	PETRIT	ÇEKINI	244.3
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
136	MIMOZA	FADIL	DUKA	272.1
137	ALTIN	QAMIL	SHABANI	218.7
138	ASLLAN ALTIN	HYSEN ASLLAN	PLAKAXHIU PLAKAXHIU	500
139	XHEMILE	FETAH	BARDHI	187.5
140	XHEMILE	FETAH	BARDHI	273.6
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
141	FILIP	IASK	PANXHI	26.2
142	AGIM	MAKSUT	SADIKU	35.5
143	AGRON	BASHKIM	LUMANI	179.4
144	BUJAR	HALIL	KALLO	17.4
145	SOKOL	NEBI	KOÇI	235.3
146	ILIR	LUTO	BANI	111.6
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA				
147	HAXHI	JAKUP	BALLIU	132.9
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA				
148	MIFTAR	QAZIM	ALLIU	245.1
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA				
149	ANDON	SELIM	BALLIU	464.1
150	LUTFI	LUMAN	ZAJAKU	42.8
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA				
151	XHEMILE	RAMADAN	ZAJAKU	24.5
152	FERDINAN	XHEZAR	KURTI	227
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA				
153	SHPËTIM	BELUL	KOÇI	363
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA				
154	IDRIZ	EMIN	HOXHA	291.6
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA				
155	ILIR	IBRAHIM	MENALLA	333
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA				
156	SELIM	ISMAIL	XHEPI	413.4
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
157	MISIR	MUSA	XHELO	368.4
158	BLERTA MNUSH	MUSTAFA MENSUR	TAHIRAI VERÇANI	22.6
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
160	ILIRJAN	ABDYL	BARJA	268.5
161	SULEJMA	ABDYL	BARJA	341.7
162	FEJZI FATBARD	BEXHET IZET	HAZIZOLLI HAZIZOLLI	10.5
163	ARDIAN	LAVDIM	LUFO	66

164	THOMA VASILIKA	SPIRO JORGJI	BIBA BIBA	271.3
165	DAVID	HYSEN	KULLAU	14.2
166	DAVID	HYSEN	KULLAU	95.6
167	VENEMIN SHPRESA	KOVI SPIRO	BALLA BALLA	68.2
168	PELLUMB	ZALO	GURRA	432
169	SADUE	LUTFI	ÇEPA	317.1
170	JOSIF	DHIMITER	HOGA	340.5
171	PETRIT	VIKTOR	SULONJAKU	308
172	ILIA	VASIL	PRILIS	325
173	VANGJEL	JOSIF	TOLLUMI	167.6
174	ASTRIT MARJETA	FEJZI BEJTO	ABZOVA ABZOVA	263.1
175	AFRIM MIMOZA	ALI SPIRO	HAKA HAKA	173.9
176	LUAN	RUSHAN	BAJRAMI	251.8
177	DHIMITER	HAMIT	MOLLISI	25.9
179	PERPARIM	NEBI	LUMSHI	155.5
180	ELTON	ISMAIL	CERRIKU	27.5
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
181	HEKURAN MIKEL	JONUZ HEKURAN	TASHI TASHI	280.35
182	RESHIT EDUART	HASAN OSMAN	HIDA BAJRAKTA	500
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
183	HALIT	OSMAN	ISLAMI	34.05
184	ASTRIT	EMIN	ÇERENI	383.1
185	JAKUP	RAKIP	ALIU	303
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
186	DALLAND	DEMIR	ÇELA	40.6
187	VANGJEL VERONIK	JANI VASIL	GJONI GJONI	39.2
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
188	DAFINA	LLAZI	SOTIRI	380.7
189	VELI	SULEJMAN	FILJA	131.2
190	ENVER LINDITA	RAMADAN RAHMI	BAJGORA BAJGORA	23.5
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
191	LULZIM	XHAFERR	SINA	277.8
192	ARBEN	SHAHIN	KASA	265.5
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
194	NEZIR	FETA	BAHO	322.8
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
195	LUTFI	JAHO	ÇELA	251.1
196	FATI	SHEFQET	KIKUA	294.3
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
197	XHAFER	SABRI	GOSTIMA	322.2
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
198	JONUZ	LIMON	SINA	426.3
199	GANI TEKI BESIM	ZEQIR GANI GANI	KULLAFI KULLAFI KULLAFI	372.6
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
200	POLIMER MINA LIRI	MINA FILIP	PALIS PALIS PALIS	85.2
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA				
201	XHEMILE	ISUF	KOKOLI	23.1
202	VIOLETA	ISA	MEMA	91.3
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA				
203	XHXHE	OSMAN	NEZHA	201.6
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA				
204	NAIM	SELIM	BOGDANI	234.9
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA				
205	ALEKSAN	NEKI	TOÇKA	324.3
206	NEKI ERGYS	XHELO NEKI	TOÇKA TOÇKA	290.4
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA				
207	BANUSH	GANI	MUÇA	316.5

Table with columns: Name, Surname, Birthdate, Gender, Name, Surname, Birthdate, Gender, Name, Surname, Birthdate, Gender, Name, Surname, Birthdate, Gender. Includes a sub-section 'Stomatologji Maj 2019' with columns: Nr, Emri, Atësia, Mbiemri, Orari.

Si realizohet grimi horror në filma dhe në teatër

Pranvera Metolli: Sfidave nuk u trembem, ja si e përjetova ndarjen nga Rezart Veleshnja

"Në Shqipëri nuk vlerësohen si duhet njerëzit që krijojnë"

Egla Xhemali

Puna me "make up"-in është sa e lodhshme, aq edhe e bukur. Ajo ka zgjedhur një formë mjaft të veçantë për të depërtuar në brendësi të artit. Të realizosh grimin horror nuk është fare e thjeshtë, por për të është kënaqësi e jashtëzakonshme. Pranvera Metolli vjen në një rrëfim për "Gazeta Shqiptare" për të na treguar sekretet e profesionit të saj, si dhe për të zbuluar jetën përtej punës. E pyetur për punimin më të çuditshëm që ka arritur të realizojë deri më sot, ajo pohon se ka qenë një nga grimet e filmit "Bloodlands" nga regjisori australian Steven Kastrissios, ku duhet të punonte fort për t'i bërë thujse reale plagët në trup, duart e këmbët e prera, zorrë e dala jashtë dhe gjakun. Ky pasion për këtë grim, që jo rrallëherë i frikëson njerëzit e ka shoqëruar që në fëmijëri Pranverën. Duke u ushtruar e duke kryer dhe studime për të realizuar punë sa më efikase, Metollit i janë hapur dyert e teatrove të ndryshme, në të cilat është njohur me artistët më në zë shqiptarë dhe jo vetëm. Më tej, tek rrëmojmë në jetën përtej punës, grimierja na thotë se bën një jetë të qetë dhe i dedikon mjaft kohë qenushit të saj. Një krisje zemre nuk e ka ndaluar atë të ecë përpara dhe të besojë te vetja. Pranvera i dha fund lidhjes me aktorin e humorit Rezart Veleshnja. Vëmendja e mediave dhe thashethemet e bënë atë të kuptonte se ishte më e fortë seç e kishte menduar.

Si ka lindur dëshira për t'u marrë me grimin horror?

Dëshira ime e madhe që në vegjëli ka qenë të bëja gjëra ndryshe. Gjithmonë dëshiroja të isha unike në stilin tim. Ndoshta shumë pak njerëz do ta pëlqenin, ama mjaftonte që unë të ndihesha e plotësuar. Para gjashtë vitesh pashë një video tutoriale në internet, e cila gërvishi imagjinatën time. Ishte një grim horror, një djeçie e shkallës së tretë. Me mjete provizore në shtëpi u mundova ta krijoj në lëkurën time dhe vura re që ju për afrova asaj që pashë. Në ato momente ndjeva emocione të veçanta. Pas asaj dite kërkova për një universitet jashtë Shqipërisë, ku të



specializoheshia fiks në këtë profil dhe ja ku jam sot.

Cilat janë vështirësitë më të shpeshta që hasni në punën tuaj?

Cdo punë ka vështirësi. Profesionit që unë ushtroj është krijim. Në botë të krijosh vlerësohet pafund, ndërsa në Shqipëri është pak më ndryshe, se nuk jemi kulturuar ende me pjesën e vlerësimit të njerëzve që krijojnë, si nga ana e pagesave, si nga ana e aftësive profesionale.

Profesioni ju ka lidhur me shumë personazhe të famshëm. Sa tekanjozë janë ata? Kush është më i paduruar?

Të punosh me artistë është e vështirë, por njëkohësisht është edhe gjë e bukur. Sfidat janë gjeja e vetme, të cilave nuk u trembem aspak. Karriera ime nisi dhe po zhvillohet përkrah artisteve dhe në këtë formë arrijmë gjithmonë të gjejmë gjuhën e përbashkët.

Punimi më i çuditshëm që keni realizuar?

Te kjo pyetje më keni zënë pak ngushtë, sepse përgjithësisht punimet e mia të tilla janë për njerëzit normal. Nëse ju them plumba nëpër trup apo zorrë të dala dhe gjak pafund, për mua janë punime normale. Punimi më i çuditshëm deri më sot është një nga grimet e filmit "Bloodlands" nga regjisori australian Steven Kastrissios, ku duhet të realizoja një grim të nivelit të lartë të plagëve në trup, duar e këmbë të prera, zorrë të dala jashtë e gjak. Emocioni më i veçantë i një punimi nga unë.

Me çfarë po merreni aktualisht?

Aktualisht jam duke bashkëpunuar me një regjisor të ri të quajtur Marius Derishi, i cili po realizon filmin e tij të parë. Jam e lumtur që jam pjesë e këtij projekti, sepse është një nga ekipet më të mira me të cilat kam bashkëpunuar deri më sot dhe jam ndier tepër e vlerësuar. Po

ashtu jam dhe në një shtafje teatrale, në Teatrin Kombëtar Eksperimental me regji të Milto Kutalit me veprën "Magjia e Jozef Bider", interpretuar nga aktori Arben Derhemi.

Keni kaluar një periudhë delikate në jetën private. Si e keni përjetuar vëmendjen që morët pas ndarjes nga Rezart Veleshnja?

Të ndahesh në moshë të re nuk është e kollajtë, aq më tepër të jesh person publik dhe të të cenohet privatësia. Ishte një sfidë e radhës për mua, nga e cila mësova që isha më e fortë nga sa e mendoja më parë.

Si është Pranvera përtej punës?

Përtej punës koha ime e paktë e lirë i dedikohet total-

isht qenushit tim të vogël. Më pëlqen të bëj shopping dhe të udhëtoj.

C'do të thotë për ju të vishesh bukur për një maskull?

Të vishesh bukur është kulturë dhe respekt për veten. Të vishesh bukur për dikë tjetër është si të imponohesh për të bërë diçka për tjetrin.



Juka ndodhur edhe ju? Eni i bën "gjëmën" Gretës dhe përpiqet të justifikohet

Nëse keni një motër apo një vella, kjo eksperiencë patjetër që do t'ju ketë ndodhur edhe ju. Keni vënë re kur keni planifikuar të vishni diçka nga gardëroba juaj dhe në momentin që kerkoni për të, zbuloni se ua kanë marrë? Epo duket se motrat Koçi dhe kanë pasur pikërisht të njëjtën zënkë. "Nuk është se nuk kam rroba për të veshur, por si më rrinë rrobat e motrës, nuk më rrinë të askujt", shkruan Eni, e cila na sqaron se nga i vjen mania për t'i veshur gjërat e së motrës dhe duket sikur po përpiqet të justifikohet. Shpresojmë që Greta ta ketë kuptuar dhe ta ketë falur për këtë mani të sajën.



Zbulohet e vërteta e ndarjes së Feros dhe Arbenitës

Ndarja e papritur e reperit Fero dhe modeles Arbenita u kthye menjëherë në lajmin e ditës, duke çuditur fansat si të reperit, po ashtu edhe të modeles. Npërmjet "Instastory"-t, Fero shkruante: "Ç'kemi vajza, tani e tutje jam beqar". Menjëherë më pas modelja postoi një "story" me një emoji duke qeshur. Kjo sigurisht na u duk si shaka fillimisht, por çifti fshiu më pas fotot me njëri-tjetrin. Fero fshiu nga "Instagram"-i të gjitha fotot me modelen dhe kjo e fundit la vetëm dy prej fotove me Feron në profilin e saj. E megjithatë, fakti që Fero dhe Arbenita akoma ndiqen në "Instagram" i ka lënë fansat konfuzë mbi këtë situatë. Gjithsesi, e vërteta nuk vonoi dhe u zbulua se në fakt e gjithë kjo është vetëm reklamë për këngën e re që Fero do të publikojë së shpejti. Postimi i reperit për ndarjen është pjesë e tekstit të këngës së tij të re.



E akuzuan për mashtrim, Morena Taraku ua mbyll gojën të gjithëve me këtë veprim

E akuzuan ashpër se po mashtronte për suksesin në Turqi. Ajo prej disa kohësh po punon për projekte të reja, të cilat pritet shumë shpejt të publikohen e t'i hapin rrugën për t'u bërë e famshme në tregun ndërkombëtar. Të tillë kanë qenë edhe titujt që bukuroshja seksi ka shpërndarë në "InstaStory" së fundmi. "Morena Taraku do të fillojë nga shteti ynë për t'u bërë një yll ndërkombëtar. Morena ka fituar çmimin si këngëtarja më e mirë e Ballkanit dhe ka përfaqësuar Kosovën në shumë kompeticione që nga viti 2010", shkruajnë mediat turke. "Turqia do më hapë dyert e botës. Po realizoj ëndrrat e fëmijërisë sime. Kam një surprizë të madhe", u shpreh Morena për mediat turke. Disa nga artikujt e gazetave turke me titujt: "Turqia do më hapë dyert e botës", - ishte një tjetër artikull i publikuar në "Instastory-n" e saj.



Çfarë nuk di të bëjë Tayna? Reperja do t'ju habisë me deklaratën e saj

Tayna është një nga reperet më të njohura e të komentuar të momentit si për karrierën, edhe për lukun e saj. Që prej publikimit të këngës "Columbiana" dhe suksesit që ajo hasi, Tayna ka sjellë projekte të ndryshme muzikore, duke u kthyer në një nga këngëtarët më të preferuar. Ajo është shumë aktive në rrjetet sociale, ku publikon shpesh foto e video nga më të ndryshmet për ndjekësit e saj. Dje na tregoi një detaj që nuk e dinim. Shumë goca mund të ndihen mirë kur e bëjnë 'make up'-in vetë, por siç duket Tayna s'di ta bëjë këtë gjë. Është vetë reperja që ka publikuar një foto ku shfaqet me grimieren e njohur Sellma Kasumović dhe 'make up' artistin Onik Zeqiri, por përshkrimi që bëri ishte shumë interesant. "Kaq shumë 'make up' artistë dhe unë akoma s'di të bëj 'make up'-in vetë", shkroi Tayna.



Gruevski mungesa në Kuvend, s'ka një vendim për mandatin e tij

80 vota largojnë ish-kryeministrin maqedonas, deputetët janë të pavendosur në zgjedhje

Ende është e paqartë nëse shumica do të arrijë të sigurojë 80 votat e nevojshme që Gruevski të mos jetë më deputet, meqë tetë deputetët e ndarë të VMRO-DPMNE-së janë të pavendosur se si do të votojnë. "Ata vazhdojnë të jenë të pakapshëm për mediat për të bërë të ditur qëndrimin e tyre. BDI-ja, nga ana tjetër, bën të ditur se do të votojë për marrjen e mandatatit. Bashkimi Demokratik për Integrim, pa asnjë hamendje, do ta përkrahë

marrjen e mandatatit të Nikolla Gruevskit" - tha Artan Grubi, deputet i BDI-së. Seanca e Komisionit për Çështjet e Rregullores, Mandatatit dhe Imunitetit për të shqyrtuar mungesën e paarsyeshme gjashtëmujore të deputetit Nikolla Gruevskit në Kuvend nuk është caktuar akoma. Pritshmëritë, sipas paralajmërimeve të kreut të këtij komisioni Pavle Bogo-



evski, janë që komisioni të mbahet të hënën dhe, nëse arrihet që ai të vendosë për marrjen e mandatatit, debati do të zhvendoset në seancë plenare. Që do të votojnë "kundër" nuk e potencojnë as deputetët e VMRO-DPMNE-së. "Kur të vijë procedura në plenare do të shohim se çfarë do të bëjmë. Edhe unë personalisht, kur të vijë procedura, atëherë do

të vendosim. Unë nuk jam deputete e pavarur - tha Dafina Stojanovska, deputete e VMRO-DPMNE-së." - u shpreh ai. Ish-kryeministri Nikolla Gruevski u arratis në nëntor të vitit të kaluar pas dënimit me burg prej dy vitesh për lëndën e Prokurorisë Speciale "Tanku" për blerjen e Mercedesit' luks. Pasi fitoi të drejtën e azilit politik në Budapest, autoritetet hungareze deri tani nuk i janë përgjigjur kërkesës së Shkupit zyrtar për ekstradimin e tij. Nga janari, pas disa ndryshimeve ligjore, Gruevski nuk e merr më rrogën e deputetit.

Krimet e luftës, Thaçi: Formimi i komisionit, puna më e mençur

Prokuroria Speciale: Të hetohet dëshmia e publikuar nga Brovina

Përdhunimet e serbëve, denoncimi në Kuvendin e Kosovës

Pas publikimit të fotografisë nga deputetja Flora Brovina, e cila dëshmon për krimet serbe të kryera në Kosovë, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka njoftuar se do të hapin hetim lidhur me këtë çështje. Ajo bën të ditur se do ftojnë deputetën Brovina, për dhënie të informacionit lidhur me viktimitë për të cilën ajo pohon se është e gjallë, si dhe dorëzimin e fotos dhe dëshmitave që ajo pohon se i ka lidhur me këtë rast dhe rastet tjera. Në njoftimin e bërë nga Prokuroria Speciale, thuhet se ata kanë kuptuar për ekzistencën e kësaj dëshmie, vetëm pas publikimit nga deputetja dhe se deri tani nuk kanë pasur dëshmi nga askush për këtë rast. Prokuroria Speciale, fton të gjithë ata që kanë dëshmi të ndryshme, si video, fotografi apo edhe dëshmi tjera, të cilat mund të jenë të rëndësishme për identifikimin e kryerësve të mundshëm të veprave penale që lidhen me krimet e luftës, t'i sjellin në Prokurorinë Speciale, pasi një shtet ligjor provat dhe dëshmitë për krimet të pretenduara dorëzohen së pari, në prokurori apo polici e jo përmes mediave apo gjatë debateve parlamentare. Në këtë rast, teksta në Kuvendin e Kosovës zhvillohej seanca plenare për votimin e rezolutës për gjenocidin serb, deputetja Flora Brovina ka paraqitur para mediave një dëshmi tepër tronditëse. Deputetja e PDK-së ka publikuar një fotografi ku shihet se si ushtarët serbë përdhunonin në grup një femër gjatë luftës në Kosovë. Në foto duket se përdhunimi kryhet në prani të familjarëve të gruas, madje shihen qartë edhe gjurmët e gjakut. "Kjo është vetëm njëra nga mënyrat kur i kanë detyruar familjarët që ta shohin aktin e dhunës seksuale. Shumë raste kemi kur ato janë mbledhur shumë në



numër dhe sistematikisht janë dhunuar nga ushtarët serb." Deputetja e PDK-së nuk ka dhënë detaje se në cilin vend ka ndodhur ky rast, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së privatësisë së gruas. "Gruaja është 50 vjeç, kur ka ndodhur ka qenë 35 vjeç. Tani është zgjar vetëdijësimi institucional që për këto viktimat të ngrihen aktakua. Serbia është fajtorja", ka thënë deputetja. Sipas saj, fotografia tronditëse nga të rrallat që dëshmojnë makabritetin e sjelljes serbe në Kosovë, është gjetur në aparatin e një ushtari serb. Nga ana tjetër, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, përkrah nisimën e kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli lidhur me krijimin e Tribunalit për gjenocidin serb, duke e cilësuar si

punën më të mençur që mund të bëjë Kuvendi. Thaçi kërkoi që të bëhen të gjithë së bashku për të dënuar gjenocidin serb në Kosovë, në mënyrë që autoritët e krimeve të dalin para drejtësisë. "Debati dhe mundësia e nxjerrjes së rezolutës dhe formimi i një komisioni janë punët më të mençura të mundshme që mund të bëjë Kuvendi i Republikës së Kosovës. Është një ide shumë e mirë e kryetarit Veseli dhe besoj që të gjithë do të jenë së bashku të dënojnë gjenocidin, spastrimin etnik të Serbisë, dhe njerëzit që kanë kryer këto krime, njerëzit e aparatit shtetëror të Serbisë të dalin para drejtësisë", tha ai. Deklaratën e tij, Thaçi e bëri pak pasi u pyet nga gazetarët pas daljes nga Kuvendi.

SHKURT



Të dënuarit e "Kumanovës": Fol shqip, këtu është Shqipëri

Në atmosferë të tensionuar ka filluar seanca e djeshme e Gjykatës së Apelit, në të cilën shqyrtohen ankesat e Grupit të Kumanovës, të cilët janë dënuar me burg për ngjarjet në Lagjen e Trimave. Seanca filloi me një minutë heshtje për pjesëtarët e vdekur nga Grupi i Kumanovës, të cilën, në emër të të gjithëve, e kërkoi Genci Sefa. Më pas ai së bashku me të akuzuarit e tjerë kërkoi që të lexohet deklarata e përbashkët e tyre, por nga gjykata u paralajmëruan se janë në seancë publike, e jo në gjykim. Pas kësaj, pjesëtarët e Grupit të Kumanovës kërkuan që gjykatësja të flasë shqip. "Katër vjet presim të flasim. Kërkojmë hetim ndërkombëtar, nuk jemi të kënaqur nga avokatët, një vit nuk kemi pasur komunikim. Kjo është Shqipëri, ne jemi autoktonë", kanë thënë disa nga të akuzuarit në seancë, raportojnë mediat në gjuhën shqipe në Maqedoninë Veriore. Pasi gjykatësja nuk ju lejoi të lexojnë deklaratën e përbashkët, ata u çuan në këmbë dhe kërkuan të mos vazhdojnë seancën, ndërsa gjykatësja i lejoi pasi prania nuk është e detyrueshme. Në deklaratën e përbashkët të tyre, të akuzuarit për ngjarjet në Kumanovë kërkoi nga kryeministri Zoran Zaev t'i nxjerr dëshmitë e vërteta, për këtë rast, të cilin ata e quajnë të montuar politikisht. Në deklaratën e lexuar, shihet se Grupi i Kumanovës si dëshmitarë për këtë rast ka propozuar ish-kryeministrin Nikolla Gruevski, kryetarin e BDI-së Ali Ahmeti, Gordana Janukuloskën, Musa Xhaferin, Gjorge Ivanovin, Bekir Asanin dhe disa ish-funksionarë të tjerë shtetërorë. Seanca në Gjykatën e Apelit do të vazhdojë dhe sot pa praninë e disa të akuzuarve. Ndërsa ankesat e tyre do t'i përfaqësojnë avokatët e tyre. Jashtë Gjykatës së Apelit ka forca policore, ndërsa familjarëve e të akuzuarve nuk u është lejuar të fusin në gjykatë lëndë të forta.

Analisti sulmon Flora Brovinën: Turp, je mashë e pushtetit

Analisti politik Haki Abazi ka reaguar ashpër, pas publikimit të një fotografie, ku shihen disa ushtarë serbë duke dhunuar seksualisht një grua shqiptare gjatë luftës. Abazi shprehet se fotogra duhet të ishte material për gjykata dhe serbët të merrnin dënimin e merituar, por shton se ajo publikohet duke trazuar ndjenjat e popullatës shqiptare. **SHKRIMI I PLOTË I ANALISTIT HAKI ABAZI:** Ju jeni për turp Flora Brovina. Ju jeni bërë, jo për herë të parë masha e mbeturinave të qelbura. Ju jeni pjesë e hordisë mafioze që keni kapur Kosovën dhe doni t'ia nxirni edhe atë pak frymë e nder që e ka. Po, janë femrat e dhunuara që i ka kryer Serbia si krime gjatë luftës po ju nuk jeni ajo që mendoni se jeni duke e zbuluar këtë gjë me një fotografi, përkundrazi. E gjithë Kosova dhe tani edhe bota e di këtë gjë. E dinë edhe nga Vasfije Krasnigji-Godman. Por ato e dinë dhe ndajnë dhimbjen e përkrahjen jo për poema politike e as për të mbuluar krimin, korrupsionin dhe dëshimet e ndarjes së Kosovës dhe gjithëka tjetër që është e stampuar me vulën e PDK, partisë të cilës ti verbërisht i ke shërbyer dhe vazhdon t'i shërbesh. Ti që ke qenë sabotuesja e Kushtetutës duke e mbajtur peng gjithë parlamentin për të zgjedhur Veselin kryetar dhe për të bërë një qeveri, e cila s'i ka shërbyer popullit dhe interesave të vendit. Ju jeni përfituese luftime përfituese paqejë që ka instaluar mendësinë e nepotizmit dhe korrupsionit si normë të pranuar shoqërore-ky është dhunim i gjithë popullit, ajo që po bëni ju. Ju nuk keni bërë zë kur Shaip Muja ka dalë në foltore të parlamentit dhe ka thënë se të dhunuarat nuk janë viktimat, ju nuk keni votuar për ligjin për viktimit, dhe ju për 20 vite nuk keni folur asnjë fjalë të vetme në dialogun me Serbinë. Nuk ju lejohet sot që ju, themeluesit e gjykatës speciale të përdorni dhembjen dhe dhunimet e grave shqiptare për të treguar "patriotizmin" e shpifur e për të mbuluar të zezat tuaja. Ju nuk keni folur asnjë fjalë as për dhunimet e vajzës nga Drenasi që janë bërë nga njerëzit me uniforma dhe pjesëtarë të institucioneve shtetërore tona sot. Dhunimet e luftës të armikut kanë vazhduar pas luftës dhe ju jeni spektatore në rastin më të mirë, e mirëmbajtës e një pushteti në rastin më të keq i cili nuk ka dënuar as ato të luftës e as këto tani e ty nuk të është dëgjuar zëri deri më sot kur ke nxjerrë një fotografi të zhbrabritur që do të duhet të ishte material i gjykatave dhe jo fyerje ndjenjave dhe emocioneve të popullatës që po dhunohet në vazhdimësi.

DEBATI

SKËNDER GJINUSHI

(Një politikan?) Kandidat i vetëm për kryetar të Akademisë së Shkencave

Fatmira Nikolli

Akademia do vazhdojë rrugën e saj. Ofron bash këpënime me Këshillin e Ministrave më qëllim realizimin e reformës për shkencën. Gjërërat duhet të jenë të konsoliduara në një ligj. Tani kemi vendosur një standard evropian" (1 mars 2019-Skënder Gjinushi).

Skënder Gjinushi është zyrtarisht kandidati i vetëm në garë për kryetar të Akademisë së Shkencave. Njeriu që ka qenë në krye të grupit të reformës, që është marrë me ligjin dhe ka debatuar prej pothuaj një viti me akademikun Artan Fuga do të jetë praktikisht kryetari i Akademisë së Shkencave pas zgjedhjeve të datës 24 maj. Me gjasë nuk do të kishte emër tjetër më të favorshëm për të ruajtur dhe ofruar raporte bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave, zgjedhjet e së cilës në shtatorin e pothuaj dy viteve më parë u cilësuan farsë dhe u anuluan. Kjo vetëm se kandidatë qenë dy akademikë që kishin qenë më herët kryetar e nënkryetar dhe kishin ndërruar vendet me njëri-tjetrin. Dy vite më pas, cili do të jetë emri që do të marrin zgjedhjet, kur duhet të bësh "zgjedhje" mes një emri të vetëm që nuk ka askënd përballë? Ish-ministër Arsimit në vitet 1987-1991 (në foto takimi i tij me studentët krah Ramiz Alisë) dhe kryetar i një partie politike për pothuaj gjithë vitet e demokracisë, Gjinushi tanimë rikthehet në shkencë duke synuar institucionin e saj më të madh, ndonëse ende krejt honorifik dhe dy vitet e fundit i varur krejtësisht nga qeveria, edhe për shkak të reformës së kërkuar. A do të arrijë vallë ish-ministri, të ringjallë akademinë që sipas kryeministrit shërbente vetëm për varrimet? Si ish-aleatë politikë Rama dhe Gjinushi mund të gjejnë gjuhën e komunikimit, por sa opONENTE dhe objektivë do të mund të jetë Akademia kundrejt qeverisë, kjo mbetet për t'u parë.

Për nënkryetar kandidon muzikologu Vasil Tole që prej 5 viteve ka qenë sekretar shkencor i Akademisë. Ndërkaq për pozicionet e Sekretarit Shkencor kandidon Salvador Bushati dhe për pozicionin e Kryetarit të Seksionit të SHNT-së akademik Neki Frashëri.


ZGJEDHJET NË AKADEMI, SI ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME
A mund të quhen zgjedhje nëse kandidati kandidon me vetveten? Kjo është pyetja një milion dollarësh! E njëjtë pyetje vlen nëse mund të quhet konkurs dikush konkurrenca i vetëm. Skënder Gjinushi ka qenë hokatar. Pyetje për replikat e Artan Fugës i ka marrë me sportivitet dhe u është përgjigjur me ironi.

Ish-ministër Arsimit në vitet 1987-1991, tani në krye të 'Shkencës'

Vasil Tole kandidohet për nënkryetar, zgjedhjet më 24 maj



Skënder Gjinushi, ish-ministër i Arsimit në vitet 1987-1991 gjatë takimit me studentët krah Ramiz Alisë



Skënder Gjinushi dhe Ramiz Alia

nushi ka qenë hokatar. Pyetje për replikat e Artan Fugës i ka marrë me sportivitet dhe u është përgjigjur me ironi. Ka qenë i qeshur e në humor në secilat pyetje-përgjigje me gazetarët gjatë muajve që merrej me reformën. Dhe kjo është puna kryesore që ai ka bërë që prej vitit 2017- ku në zgjedhjet e përgjithsh-

hme ai nuk mbledhi votat e nevojshëm për të qenë deputet në parlament. Skënder GJINUSHI (1949). Matematikan, profesor, akademik. Lindi në Vlorë. Shkollën e mesme e kreu në Tiranë dhe përfundoi studimet e larta në Universitetin e Tiranës në vitin 1972. Gjatë viteve 1973-1977 ai ka qenë ndër të paktët

demokrate të Shqipërisë, funksion nga i cili ka hequr dorë.

Nga viti 1992 deputet në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar i Kuvendit (1997-2001); zëvendëskryeministër e ministër i Punës dhe i Çështjeve Sociale (2001-2002).

23 NËNTOR 2017

Çfarë deklaronte Gjinushi ditën që nis "udhëtimi" i tij për kreu e Akademisë? Në një takim në Cod para kryeministrit, ditën kur Edi Rama shprehej se Akademia e Shkencave është si shtëpi varrimi,

Skënder Gjinushi thoshte se "duhet të 'i ndajmë gjërë, pasi janë dy probleme: 1) Reformimi i brendshëm i Akademisë, dhe 2) Çfarë vendi do të zërë Akademia në kuadrin e kërkimit shkencor në Shqipëri? Duhet që të kuptohet se situata ku ndodhet nuk është përgjegjësi e Akademisë në tërësinë e vet". Sipas tij, kërkimi shkencor në Shqipëri ka bërë mbrapa për dy arsye, 1) U godit dhe ra statusi i instituteve, një numër instituteve edhe u shkrinë. 2) Vetë kërkimi shkencor në shkollat e larta nuk është në atë nivel që duhet, se kemi mijëra doktoratura, që nëse flasim për cilësinë e tyre, lë shumë për të dëshiruar. "Por një problem kryesor që ka Shqipëria është edhe eksporti apo emigracioni i trurit, që do të thotë se më të zotët apo më të aftët nuk rrinë më këtu. Kështu që për të dyja këto arsye, edhe për një politizim shumë të madh të reformës së fundit, bëri që ASH të kthehet në një organ honorifik. Një organ honorifik nuk është ai që prodhon shkencën, sepse shkencë prodhohet në katedra, atje ku investohet edhe njerëzit janë aktivë", deklaronte Gjinushi.

Ai pyeste a do të kemi një ASH honorifike apo një ASH, e cila të ketë edhe funksione në institute? Problemi është që në të gjithë piramidën e kërkimit shkencor, cili do të jetë roli i ASH, i një qendre të koordinimit të kërkimit shkencor, por ka rëndësi edhe reformimi i brendshëm. "Në bazë të funksionit, të shihet edhe përbërja apo kriteret e Akademisë. Në kohën e lavdishme, Akademia e kishte gjithë trurin e Shqipërisë këtu. Atëherë Akademia ka pasur cilësi më të lartë për shkak të kësaj, por, edhe sepse kërkimet e instituteve kanë qenë në kuadër të ASH-së. Sot problemi është i qeverisë, ministrit, instituteve, se si do luftojmë për ta rimarrë apo ringritur. Nëse do të anatemojmë ASH, anatemohet ajo që vetë kërkimi shkencor në Shqipëri është i hallakatur, ka rënë niveli edhe ata që kanë pasur më shumë sukses janë larguar". pati thënë ai.

shqiptarë që kreu studimet pauniversitare në Francë (Universiteti Pierre e Marie Curie, Paris VI) dhe fitoi titullin "Doktor" i ciklit të tretë në analizën funksionale.

U emërua pedagog në katedrën e matematikës së specialitetit në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës (1972). Skënder Gjinushi ka botuar tekstin "Bazat e topologjisë së përgjithshme" (1986), "Analiza funksionale" (1988), "Probleme të analizës funksionale (1992) dhe një varg artikujsh shkencorë në fushën e analizës funksionale.

Jeta e tij politike nis në vitin 1987, kur u bë deputet deri më 1991 në Kuvendin Popullor dhe ministër i Arsimit. U aktivizua në proceset politike pluraliste dhe më 1991 u zgjodh kryetar i Partisë Social-

PËRVJETORI

98 vjet nga lindja e Guri Madhit, "Dhimbjen nuk e shihte, e prekte"

Fatmira Nikolli

Në përgjithësi Guri Madhi nuk ka ndikim të drejtpërdrejt nga ndonjë autor. Ka një qasje nga baroku në tërësi dhe nga arti romantik. E njëjshëm mirë realizimin kritik francez, veçanërisht Honore Daumier. Dëjka nga Renato Guttuso dhe Eduard Hoper. Nga meksikanët ka ndikim tek vepra "Komiti" versioni i me ngjyra 1987. Po kështu nga Aleksandër Dejneka dhe me pak Serjan. Në të gjitha rastet është Guri. Ka ndoshta në veprën e tij me shumë vitalitet dhe sinqeritet se këta të fundit. Ishte më popull se ata. Dhimbjen nuk e shihte e prekte", kështu shkruan për artistin Guri Madhi, Hermion Madhi, i nipi po ashtu artist. Kujtesa bëhet me rastin e 98-vjetorin të lindjes.

Sipas tij, Guri kishte dhuntinë të qëllonte në shenjë. Në pikturën moderne ndjehet frymëzimi nga Vrubel e Kandinski, Gauguin, Matisse, Vlamic, Van Gog, Picasso dhe Munch. "Sipas meje në veprat e tij të pavdekshme 'Shpella e Dragobisë', 'Dorëzimi i armëve', 'Shtabi i përgjithshëm', 'Pëllëmbë e gjak' ai është autentik, i papërsëritshëm dhe i vetmi piktor shqiptar me peshë, simbol i vitalitetit..." shkruan Hermion Madhi, nipi i Gurit Madhit.

Ai vëren se në artet pamore shqiptare deri në vitin 1990 ka dhjetëra vepra të shkëlqyera kompozicionale, por vepra identifikuese ka pak. Pa diskutim në skulpturë është Odhise Paskali jo më një veprë! Jo me nudo të bukur, jo interesant! "Të tilla histori bota ka me mijëra me cilësi tjetër dhe për para nesh. Historia shkillohet ne hapësirë dhe kohe dhe sistemi analitik i kritikës realizohet përmes risive dhe autenticitetit. Në pikturë Guri Madhi mbetet i pari: nuk ka folk as bëhet 'interesant' dhe nuk shitet për "modern". Historia e artit shqiptar është në kohe vonës, por bën përpjekje titane për t'ju përfuruar shtjellave botërore. Prandaj është shumë pak të jesh i veçantë", thotë Hermion Madhi, artist dhe nipi i Gurit. Duhet të jesh i vërtetë, shton ai. Meksikanët janë të mëdhenj se janë "britma" e popullit të tyre dhe jo vetëm. "Klithma" e Munch e gjithë botës mbarë. Sipas Hermonit, Guri Madhi është Jehona e gjakut shqiptar në një ekzistencializëm post-modern, përmes njohjes së arrijve botërore dhe talentit vetjak. Dhe për artin pamor shqiptar nuk ka rëndësi "interesantja" që e ndesh kudo para nesh, por e vërteta cilësore. Kush jemi ne! A meritojmë? Po! Sepse ne bashkëjetojmë brenda familjes evropiane me artin tonë që integrohet me dinjitet. Prandaj G. Madhi është me peshë. Se është me shumë se "interesant". Është i



Guri Madhi

Hermoni, nipi i Gurit Madhit në një skicë për gjyshin

vërtetë. Shqipëria brenda botës me dinjitet.

PORTRETI I TIJ, SIPAS YLLI DRISHTIT

Guri Madhi (Korçë 15.06.1921 - Budapest, Hungari 13.06.1988). Piktor: Mban titullin "Piktor i Popullit"

Piktori Guri Madhi është një nga artistët e rëndësishëm të Realizimit Socialist, në gjysmën e dytë të shekullit XX. Ai ishte pjesë e grupit të parë të piktoreve që studiuuan në vendet lindore (ish BRSS, Poloni, Çekoslovakia, Rumania, Bullgari, Ish Jugosllavi). Piktori Guri Madhi krijoi dhe realizoi për një kohë të gjatë tablo kompozicionale historike me frymë impresioniste, duke sjellë një risi në artin shqiptar të viteve 1950 - 1970. Në qytetin e lindjes, në Korçë, Guri Madhi kreu tri vjet në shkollën industriale italiane. Për arsye ekonomike e ndërpreu shkollën dhe hyri në punë si piktor reklamash për kinematë e qytetit "Lux" dhe "Majestik". Ndoqi kurset e pikturës në studion e piktorit Spiro Kega dhe Vangjush Mio.

Në maj 1942 e marrin ushtar dhe bën pjesë në Batalionin "Tarabosh". Përfshihet në lëvizjen antifashiste dhe merr pjesë në njësit

guerile të qytetit dhe në grupet e propagandës antifashiste. Pas çlirimit të vendit, Guri Madhi punoi si piktor në shtëpinë e kulturës (Korçë 1944) dhe më vonë (1947) si skenograf në teatrin e qytetit së bashku me piktorin Vangjush Mio. Gjatë viteve 1950 - 1956 Guri Madhi ishte student për pikturë në Institutin e Pikturës, Skulpturës dhe Arkitekturës "I.E.Rjepin", në Shën Petërsburg (ish BRSS). Mbrojtji diplomën me tablonë: "Bajram Curri në shpellën e Dragobisë". Në ciklin e tablove pas kthimit nga Rusia (1956) piktori Madhi paraqitet në ekspozitat e asaj kohe me tablo ku paraqitet një temperament impulsiv, vizatues i ndjeshëm dhe si piktor i penelatave të ngjara dhe të një dritë vibruese. Veprat, që pasuan punën e diplomës "Bajram Curri në shpellën e Dragobisë" (1956, studio e artistit), vijuan linjën e hyjnitimit të ngjarjeve të historisë së popullit në luftën për çlirim kombëtar, pavarësi dhe luftës së dytë botërore. Nga kjo periudhë mund të kujtojmë punimet: "Turqit dorëzojnë armët" (1959, GKA, Tiranë), "Demonstrata e Korçës" (1959, GKA, Tiranë), "Formimi i

Shtabit të Përgjithshëm" (1962, GKA, Tiranë), "Grua me kostum popullor" (1963, GKA, Tiranë), "Pëllëmbë e gjak" (1964, studio e artistit), "Betimi Partizan" (1968, GKA, Tiranë) etj. Një element mjaft interesant në veprat e kësaj periudhe është ndërthurja e monumentalitetit dhe lëvizjes së personazheve të shumtë në kompozimet e tij. Tablotë herë përshkohen nga nota epike, e herë-herë nga një natyrshmëri e ngrohtë dhe mjaft realiste. Piktori Guri Madhi i përket brezit të piktoreve shqiptarë që në vitet 1960-1980, trajtuan temat kompozicionale historike, një kërkese kjo dhe nga autoritetet shtetërore të kohës, që gradualisht krahas temave historike u shtuan edhe ato të ndërtimit socialist (nga puna në bujqësi, nga puna dhe jeta e rinisë, ushtria etj.). Këto tema ishin dhe pjesë e propagandës së partisë - shtet dhe realizoheshin brenda kërkesave strikte shpesh mjaft të ngurta për artistët figurativë. Nga cikllin i tablove ku ndjehet lirshmëria koloristike e piktorit Guri Madhi kujtojmë "Malësori në këmbë", "Malësori", "Portreti i nënës", "Portreti i një punëtori", "Kostum Korçar" dhe sigurisht në vepra të tjera ndjehet prania e një çensure të rreptë si mund të kujtojmë: "Në

grykë të Mezhgoranit", "Shteg me shteg me çetat partizane", "Mbledhja e Moskës", "Për mëmëdhënë", "Shtëpia ku u themelua Lidhja e Prizrenit", etj. Piktori i shkollës së realizimit socialist, Guri Madhi ka realizuar rreth 400 tablo në vaj, me qindra vizatime, në të cilat, përvçetë temave historike dhe sociale, ka shumë tablo ku trajtohen edhe marrëdhëniet e njeriut me natyrën, portrete dhe peizazhe nga zona të ndryshme të Shqipërisë, natyra të qeta me anë të të cilave piktori "proteston" heshiturazi për kontrollin mbi të cilën mbahej krijimtaria dhe për tutelën mbi ndjenjat intime të njeriut artist. Pas viteve '80 (shekulli XX) vendin e tablove historike e zënë tablotë që s'kanë nevojë për titull, ku piktori kërkon me ngulm lirinë e ngjyrës. Në tablotë e kësaj periudhe që në përgjithësi janë të dimensioneve modeste (studio e artistit), pasqyrohet shpërthimi i ndjenjave të grumbulluara për vite me radhë, klithma proteste, që në pikturën nga ana e tij jepen me ngjyra të pastra, të marra nga tubeti "Etyd" i vitit 1964" (studio e piktorit). Nga një piktor i realizimit socialist piktori Guri Madhi në vitet e fundit të jetës bëri një përpjekje të realizimeve në disa tablo, në mënyrë ekspresioniste, të cilat megjithatë nuk u ekspozuan kurrë në publik, pasi sado liberale të që atmosfera artistike dhe ajo politike e viteve 1985 - 1990 ajo nuk mund të dilte dot nga korniza e një "Liberalizimi-totalitar" socialist. Krijimtaria e "Piktorit të Popullit" Guri Madhi është një dëshmi me vlera për historinë e artit shqiptar dhe një shembull tipik i kohës kur ai jetoi dhe krijoi. Në fondin e GKA, Tiranë ruhen 36 vepra të artistit. Piktori Guri Madhi ka ekspozuar në Tiranë dhe Korçë. Artisti Guri Madhi ka qenë pjesëmarrës në të gjitha ekspozitat kombëtare kolektive dhe ato personale, të çelura që nga viti 1956. Veprat e tij janë ekspozuar në ekspozitat e çelura nga shteti shqiptar në Melbourne (Australi), Paris (Francë), Barcelona (Spanjë), Romë (Itali), Athinë (Greqi), Stamboll (Turqi), Bukuresht (Rumania), Sofje (Bullgari), Vjenë (Austri) etj.

EUROSONG

Uau! Një zë magjepsës Jonida! Ne po qajmë". Ka qenë ky koment i Eurovision ka bërë në profilin zyrtar në facebook për këngëtare shqiptare Jonida Maliqi që me këngën "Ktheju tokës", çoi Shqipërinë në finalen e Eurosong. Me tekst dhe muzikë të Eriona Rushitit, e veshur me një fustan të zi me motive tradicionale nga stilisti Ardi Asllani, e shoqëruar nga tre backvokalistë ajo ka bërë për vetë



JONIDA MALIQI ÇON SHQIPËRINË NË FINALEN E EUROSONG

juritë e vende të natës së dytë duke arritur suksesin e parë në festivalin Europian të Këngës. Veshja e saj rikrijon idenë e xhubletës por e kthyer në një veshje skenike. Në fund të këngës ajo ka përshëndetur në shqip, anglisht dhe në gjalli me një karrierë të gjuhën izraelite. Ajo ka një kar-

rierë të gjatë muzikore që nis me festivalin e fëmijëve ka shënuar një tjetër hap në art. Me një skenografi me elementë thjeshtë që sillnin zjarrin dhe folenë kënga e saj u kushtohet emigrantëve në gjithë botën. Finalja e Eurosong mbahet të shtunën.

Opinion i Ditës

Modeli ekonomik estonez...

Nga Igli Tola

(vijen nga faqja 1)

...përmasa gjeografike dhe demografike, por edhe nga e shkuara e përvuajtshme. Gjatë gjithë historisë së tyre, kanë pasur kalvare pafund përpjekjesh për liri. Në vitin 1918, shpallën pavarësinë, por u pushtua nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1940 gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke u mbajtur sikundër në nën tutelën e 'Perdes së Hekurt' për më se gjysmë-shekulli.

Ajo periudhë si për çdo shtet tjetër pati pasojë katastrofale edhe për Estoninë. Nga një vend që më 1939 standardet e jetesës i kishte pak a shumë të njëjta me Finlandën fqinje, arriti në një nivel PBB-je rreth 2.000 dollarë për frymë në periudhën që u mëvetësua. (Edhe Shqipëria në këto nivele vërtitej asokohe, diku te 1 909.6 \$ më 1991 sipas FMN-së).


Fundi i komunizmit kishte krijuar kaos të vërtetë në vend. Dyqanet ishin krejtësisht të zbrazëta dhe rubla ruse nuk kishte ndonjë vlerë. Prodhimi industrial u ul në vitin 1992 me mbi 30 % më shumë sesa gjatë Depresionit të Madh të viteve '30. Pagat reale ranë menjëherë me 45 %, ndërkohë që inflacioni i tejkaloi 1.000 % (për shembull çmimet e karburantit u rritën 10.000 %).

Njerëzit qëndronin në radhë me orë të tëra për të blerë ushqime. Buka dhe produktet e qumështit u racionuan. Për shkak se nuk kishte gaz për ngrohje, qeveria planifikonte të largonte pjesën më të madhe të banorëve të kryeqytetit, Talinit në fshat. I vetmi 'institution' që dukej se funksiononte ishte vetëm 'tregu informal'.

Deri më këtu situata ngjan 'motamo' me vendin tonë, saqë sikur të hiqim toponimet estoneze do të mendonim se flisnim për Shqipërinë.

Por, shteti baltik ndryshe nga ne 'bashkëvuajtësit' e tjerë të pseudo-komunizmit i hyri reformave me themel, duke u mbështetur në teorinë e Leszek Balcerowicz, një prej arkitektëve të reformës ekonomike polake. Ai theksoi rëndësinë e "Politikës së Jashtëzakonshme - Teorisë së Shokut", që nënkupton se një program ekonomik radikal duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur pasi 'zbulimi' ka një shans shumë më të madh për t'u pranuar sesa një program radikal i vuonuar, ose një alternativë jo-radikale që paraqet gradualisht masa të vështira shtrënguese. Sipas fjalëve të tij? "Mjekësia 'e hidhur' është më e lehtë për t'u marrë me një dozë, sesa në një seri dozash të zgjatur".

Estonia u përpoq të mësonte nga përvojat e tjerëve. Dy ishin mësimet kryesore që dolën nga ky proces. Njëra ishte që të kujdeseshin për politikat dhe pastaj të vazhdohej me reformën



ekonomike, pasi të gjitha reformat e vështira që u ndërmoren u bënë me konsensusin dhe përkrahjen e gjithë faktorit politik. Tjetri është i përmblodhur në sloganin e mirënjohur: "Vetëm bëje". Me fjalë të tjera, është thelbësore të jesh vendimtar në miratimin e reformave dhe të qëndrosh dhe punosh për to pavarësisht nga dhimbja afatshkurtes që ato shkaktojnë.

Mbi këto 2 parime tejet simple u ngrit e gjithë rimëkëmb-

ja e vendit. Nga një ekonomi me 92 % të tregtisë ndërkombëtare të varur nga Rusia u hap drejt tregut global, u implemtua me sukses taksa e sheshtë, u punua në forcimin e legjislacionit dhe reformës monetare, por me fokus në njohjen dhe zhvillimin e konceptit të pronës private.

E frytet e kësaj pune i voli dhe po i vjel me sukses prej vitesh (edhe pse u godit nga Kriza Ekonomike e 2008). Që nga fillimi i reformave të Estonisë, rritja

ekonomike ka qenë mesatarisht në nivelet 6 %, duke shënuar në vite specifike si 2006 edhe rritje dyshifrore, 11-12 %. Në pothuajse çdo standard të matur, Estonia është ndër ekonomitë më konkurruese midis shteteve anëtare të BE-së, me buxhet të balancuar dhe klimë të favorshme për investitorët.

Të gjitha këto ndryshime kanë lejuar Estoninë të përgatitet për sfidat e reja të shekullit të 21-të. Kombi bëri një kërcim të vërtetë në teknologjinë moderne dhe është pioniere në 'e-governance'. Gjatë mbledhjeve të kabinetit, anëtarët e qeverisë përdorin vetëm kompjuterë - pa asnjë letër. Estonia është tani përpara shumë vendeve të BE-së në përdorimin e internetit. Estonezët që prej viteve 2000 kryejnë një pjesë të madhe të transfertave të tyre bankare nëpërmjet internetit, deklaratat tatimore mund të dërgohen në Departamentin e Taksave në mënyrë elektronike etj.

E-Government, është shembulli më tipik estonez që na dëshmon përdorimin e një mjet shumë efektiv në krijimin e një qeverie të vogël dhe të hapur. Përdorimi i internetit nga ana e qeverisë ka krijuar mundësi të favorshme për ndërmarrjet e reja të teknologjisë së lartë. Estonia është bërë vendlindja e shumë ndërmarrjeve të tilla. Shpikja më e famshme estoneze është sistemi elektronik i komunikimit Skype, i cili u votua si markë e tretë me ndikim më të madh në botë në vitin

2006.

ndërmarrjet e reja të teknologjisë së lartë. Estonia është bërë vendlindja e shumë ndërmarrjeve të tilla. Shpikja më e famshme estoneze është sistemi elektronik i komunikimit Skype, i cili u votua si markë e tretë me ndikim më të madh në botë në vitin 2006.

Duke e parë teknologjinë si sektorin më me oportunitet për të mbështetur ekonominë, u investua në një strategji arsimore për t'i përgatitur të rinjtë me njohuritë dixhitale të nevojshme për sfidat e tregut të punës. Shifrat flasin vetë për suksesin e kësaj nisme? Numri i studentëve estonezë që ndjekin karrierë të suksesshme në sektorin IT është sa dyfishi i mesatares së vendeve të OECD, gati 10 % e gjithë numrit të studentëve. Por, treguesi më domethënës i kësaj politike është fakti që të rinjtë e këtij vendi renditen të parët në testin ndërkombëtar të PISA-s. Pra, sistemi arsimor i pajis të rinjtë jo vetëm me setin e njohurive teknike, por edhe me aftësi 'soft', aparat logjik etj.

Mbështetur në gjithë këto projekte, nën moton ESTONIA 2014-2020 qeveria ka vendosur objektiva që do ta kthejnë përfundimisht vendin në një shtet të krahësueshëm me vendet më të zhvilluara në botë. Synohet rritje e produktivitetit të punës në 80 % dhe e nivelit të punësimit në shifra rekord për vendet e BE-së.

E kështu Estonia e sotme është një vend i zhvilluar si rezultat i dekadave punë dhe inovacion. Duke përfashtuar vendet dhe territoret e vogla me status të ndryshëm ligjor, Estonia renditet e 37-ta në mesin e vendeve më të pasura në botë (PPB për frymë nga 175 vende) duke mos qenë më një vend bujqësor. Vetëm 3% e fuqisë punëtore është e punësuar në bujqësi, por me produktivitet 20% më i lartë se mesatarja e sektorit. Shumica e estonezëve (69%) punojnë në sektorin terciar, një shifër që është e sigurt të rritet një rezultat i revolucionit dixhital dhe automatizimi i të gjitha punëve rutinë dhe atyre fizike në 25 vitet e ardhshme.

Ndaj, nëse një ditë prej ditësh do të vijë ndonjë qeveri që do të mendojë realisht të zhvillojë në kuptimin e plotë të fjalës ekonominë e vendit, le të hedhin një sy edhe nga shembujt e suksesit që vijnë nga shtete si Estonia. Një shtet më të cilin nuk ndajmë vetëm të shkuarën e përbashkët komuniste, demografinë modeste; por edhe aspiratën për t'u fokusuar në sektorin terciar, shërbimin. Por, vetëm me një diferencë të madhe, ne kemi vetëm dëshirën (ëndërrën) të konkurruar në tregun e shërbimeve (kryesisht përmes turizmit), kurse estonezët prej vitesh po investojnë strategjikisht në këtë sektor duke mos u fokusuar si ne vetëm në zgjidhje të çastit dhe jo aq rentabël, si PPP-të.

Opinioni *i* Ditës

A do integrohemi ndonjëherë në BE?

Nga Dr. Klodian Muço

(vijon nga faqja 1)

... e Shqiptarëve integrimi në BE është e vetmja shpresë për të pasur zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe rritje të mirëqenies së tyre. Ky ndoshta është edhe shkaku kryesor pse qeveritë shqiptare ndër vite premtojnë dhe vendosin si objektiv primar të qeverisjes, integrimin në BE. Objektiva këto që nga një anë varet nga "dëshira dhe burokracia e Parlamentit Europian" e nga ana tjetër nga impinjimi i politikanëve shqiptarë për të rritur demokracinë në vend, për të përmirësuar mirëqeverisjen si dhe për të reduktuar korrupsionin. Impinjime këto që janë thjeshtë për aparençë pasi tek ne vazhdohet me qeverisjen tradicionale. Ku të paafët bëhen deputetë; ku korrupsioni luftohet vetëm me fjalë; ku asnjë drejtues nuk mban përgjegjësi për dëmet që i shkakton buxhetit të shtetit apo qytetarëve; ku në administratën shtetërore punojnë kryesisht militantët e paafët dhe ata që kanë miq apo të afërm në vendimmarrje; ku rruga e zhvillimit ekonomik të vendit sipas politik-bërësve kalon nga koncesionet dhe nga pasurimi i pak njerëzve. Pra kemi arrit në një pikë të tillë sa lindin natyrisht pyetjet: a e dëshirojnë vërtet politikanët tanë integrimin e Shqipërisë në BE, apo janë të huajt ata që me burokracinë e tyre po na evitojnë?

Vallë do bëhemi ndonjëherë pjesë e BE-së? A po përpiqen vërtet politik-bërësit tanë për integrimin e vendit?

Mos vallë rregullat e të qenit pjesë e BE-së janë impinjative për qeverinë dhe në të tilla kushte ndihen më komod duke qëndruar jashtë saj?

Po vendet anëtare të BE-së a janë të lumtura që janë pjesë e kësaj familjeje të madhe? A duan ato ta zgjerojnë këtë familje?

Në fakt, projekti i integrimit evropian sot është në qendër të një sulmi të brendshëm. Të brendshëm pasi po rriten gjithmonë e më tepër partitë e djathta nëpër vendet e BE-së që po i tundon ideja për t'i dhënë fund këtij projekti.

Një shembull tipik është ai i partive populiste dhe euroskeptike, që po rritin konsensusin e tyre dita ditës dhe së shpejti mund të kenë një numër të konsiderueshëm eurodeputetësh në parlamentin evropian, të cilët janë kundër monedhës së përbashkët apo kundra Europës. A po bëhet kundër pabarazisë së perceptuar se shpërndarjes së kostove dhe benefiteve e të qenit pjesë e BE-



së. Pra, mendojnë se "bashkimi me vendet e varfra" dhe emigracioni i qytetarëve të tyre po mbyllin fabrikat; po rritin papunësinë e qëndrueshme; po reduktojnë rrogat; po ulin sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve publike. Pra, sipas tyre është emigracioni i qytetarëve të vendeve të varfra të Europës drejt atyre të pasura të saj që po stimulon rritjen e pasigurisë për të nesërmen.

Jo rastësisht personat që më tepër votojnë këto parti populiste apo të djathta janë ata që kanë më pak mundësi dhe aftësi për të përballuar ndryshimet që vijnë nga konkurrenshëria globale: punëtorët e pakaualifikuar apo pensionistët.

Pra, sot fati i BE-së në tërësi apo integrimi i Shqipërisë në veçanti është në dorën e atyre që janë skeptik për rishpërndarjen e të mirave të globalizimit apo e të qenit pjesë e saj. Sipas tyre tregu dhe monedha e përbashkët gjeneron përfitime por këto përfitime

nuk shpërndahen në mënyrë të drejtë të qytetarëve.

Vendet e Europës Lindore që janë pjesë e BE-së apo ato që dëshirojnë të bëjnë pjesë, sipas tyre marrin më tepër fonde sesa kontributi i tyre dhe "eksportojnë njerëz" drejt vendeve të Europës perëndimore. Gjë që shihet si nëna e të gjitha të këqijave për shumë qytetarë të vendeve perëndimore. Pra, frika se integrimi i mundshëm i vendeve të Ballkanit Perëndimor do të çonte në një rritje të fluksit emigrator drejt ekonomive të zhvilluara të BE-së i bën këto të fundit skeptike të zgjerimit dhe i shtyn deri aty sa të mendojnë në mënyrë paradoksale se Europa e bashkuar ka më tepër kosto sesa përfitime për to.

Në kushtet kur një vend i varfër si Shqipëria që përgjatë viteve të fundit nuk po e redukton distancën që ekziston ndërmjet të ardhurave reale për frymë me mesataren e të ardhurave reale për frymë të BE-së, por

përkundrazi po e rrit këtë distancë, mund të themi se integrimi i saj në BE dhe harmonizimi me standardet e saj ekonomike do të jetë sa i vështirë po aq edhe i largët.

Nëse do të shohim projeksionet e nivelin e rritjes së të ardhurave reale për frymë të Shqipërisë në 20 vitet e fundit me rritjen mesatare të kësaj të fundit në BE do të shohim se na duhen mbi 70 vjet për të arritur nivelin mesatar të BE-së. Pra, është e vërtetë se ne kemi rritje ekonomike, por është po aq i vërtetë edhe fakti se kjo rritje është e pa mjaftueshme për të reduktuar distancat me BE-në.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për reduktimin e korrupsionit apo për nivelin e demokracisë. Këto na çojnë të mendojmë me pesimizëm se ndoshta do të kalojnë edhe dhjetëra vite të tjera dhe ne përsëri s'do jemi pjesë e BE-së.

Ndoshta kur ne të jemi gati të bëhemi pjesë e saj ndoshta dhe BE-ja s'do të jetë më siç është sot...

HOROSKOPI

DASHI

Nëse po kërkon t'i shtoni ditës më shumë emocion sot, duhet të përfshiheni në aktivitet fizik. Natyrisht, varet nga ju se në çfarë aktiviteti fizik keni dëshirë të merrni pjesë, por sa më shumë njerëz të përfshirë, aq më mirë do të jetë!

DEMI

Flisni butësisht me njerëzit që keni përreth. Kështu do të shmangni mosmarrëveshjet. Çelësi për të pasur një bisedë të mirë është që të tregoheni një dëgjues i mirë.

BINJAKET

Bëhuni gati të keni më shumë biseda intelektuale sesa zakonisht sot. Kjo është një mundësi e shkëlqyeshme për t'u treguar njerëzve të tjerë se çfarë po ndodh brenda jush në lidhje me shumë fusha.

GAFORJA

Jini shumë i kujdesshëm me impulset tuaja sot. Mos e injoroni tërësisht atë që parandjeni, por bëni kujdes të veçantë që të mos veproni duke u nxitur. Rrezikoni ta përfshini veten në situata delikate.

LUANI

Vullneti juaj është ende i fortë, prandaj mos kini asnjë shqetësim që ju do të dorëzoheni për ndonjë forcë të parëzistueshme sot. Bëhuni gati për të filluar një fazë shumë të fuqishme të jetesës.

VIRGJERESHA

Shmangni lojërat e fatit dhe mos u përfshini në baste ditën e sotme. Nuk favorizoheni në këtë aspekt. Sa i përket çështjeve të dashurisë, mund të merrni disa lajme të mira që do jua ndryshojnë ditën.

PESHORJA

Është gjithmonë e rëndësishme të kesh shpresë, por sot duhet të përpiqesh t'i bësh ato realitet. Është koha të dalësh me një plan. Kjo është një ditë për të pasur rezultate konkrete.

AKREPI

Fati juaj është gati për të marrë një kthesë drastike prej 180 gradësh, kështu që bëhuni gati! Ky mund të jetë transformimi pozitiv, shpresëdhënës që prisni - ose, mjerisht, mund të jetë fundi i një vargu të gjatë rastësish të lumtura që ju keni shijuar.

SHIGJETARI

Problemet e biznesit të dikujt tjetër nuk janë problemet tuaja, edhe pse ju do të duhet të merrni me pasojat. Kini kujdes që të mos përfshiheni më shumë sesa ju nevojitet. Mënyra se si reagoni ndaj gjërave është zgjedhja juaj.

BRICJAPI

Kur takoni njerëz të rinj, bëni kujdes kur është fjala për dhënie e informacioneve personale. Dikush mund të përdorë një moment dobësie duke ju dëmtuar shumë. Me çështjet e dashurisë kërkohet më shumë angazhim.

UJORI

Do të jeni i përfshirë nga çështjet e romancës dhe sentimentalizmit. Tregoni kurajë për t'i thënë gjërat troç. Kështu do të fitoni respektin e njerëzve që keni përreth. Sa i përket çështjeve të punës, bëni kujdes nga një person që duket shumë pozitiv.

PESHQIT

Fokusimi tek shëndeti dhe dieta do të zhvendosin prioritetet tuaja. Nuk bëni gabim që jeni më i kujdesshëm ndaj fizikut tuaj. Në lidhje me aspektin profesional, favorizoheni në aplikime ose në nevojën për të ndryshuar ambient.

SULMUESI KROAT



Tomislav Bushiq ka qënë një nga sulmuesit e huaj që ka spikatur në kampionatin tonë me Tiranën, Villazninë, por edhe Flamurtarin. Në janar u bë pjesë e Teutës dhe u konsiderua si një nga afimet e bujshme të durrsakëve, por ka pasur luhatje me dëmtimet. Në një pronon-

Bushiq kërcënon kampionët e rinj: Gati ta mundim Partizanin

cim për "Supersport", sulmuesi kroat ka pohuar: "Me këtë fitore jemi shumë afër objektivave të klubit dhe tashmë e kemi mendjen dhe jemi të përqendruar te ndeshja e radhës me Partizanin, ku synojmë pikët e plota. Mendoj se me

Europën janë të gjithë të kënaqur. Janë tri finale dhe duhet që të marrim sa më shumë pikë nga sfidat e mbetura, sepse edhe rivalët i kemi shumë afër dhe aktualisht nuk kemi siguruar asgjë. Jemi gati për ndeshjen e radhës.

Natyrisht që barazimi me një ekip si partizani që ka fituar titullin dhe e përgëzoj për këtë nuk është keq, por ne duam 3 pikët. Në Durrës do ta mundim Partizanin", - tha Bushiq në fund të prononcimit në prag të ndeshjes shtëpiake me të kuqtë.

E kishin kërcënuar një natë më parë, krahu i djathtë i presidentit Tavo goditet nga ultrasit

Tifozët e Luftëtarit dhunojnë ish-drejtorin Çavo

Aleksi flet për pezullimin: Edhe Mesi luan keq ndonjëherë



Jeton Selimi

Pezullimi i trajnerit Julian Ahmataj, zëvendës trajnerit Neritan Novi si dhe i dy lojtarëve, Albano Aleksit dhe Xheksun Ferreriras ka bërë që të shpërthejnë tifozët e Luftëtarit, të cilët kanë vënë nën akuzë ish-drejtorin Vangel Çavo për situatën e krijuar së fundmi në ekip. Sipas asaj çka raporton "Panorama Sport", drejtori Çavo është dhunuar nga disa tifozë, të cilët që një ditë më parë kishin paralajmëruar reagimin e tyre. Ata akuzojnë pikërisht ish-drejtorin për përçarjen e krijuar dhe ish-zëdhënësin për shtyp, Rigels Maliën. Pavarësisht se Çavo nuk ishte më drejtor, ai vijonte të qëndronte pranë presidentit Grigor Tavo, ndërsa ka sjellë disa elementë në radhët e ekipit bluzi, kryesisht nga tregu grek.

FLET ALEKSI

Situata e fundit të Luftëtarit, ku klubi gjirokastrit vendosi të pezullonte trajnerin Ahmataj dhe dy futbollistët, Aleksi dhe Xhek-



son ka bërë që këta të fundit të mbyllin para kohë

aventurën me bluzinjët. Mesfushori Aleksi dhe

mbrojtësi Xheksun për "Supersport" janë shprehur se

nuk e prisnin këtë vendim nga klubi, ndërsa shtojnë se gjithmonë kanë dhënë maksimumin për Luftëtarin. "Normale nuk ndihem mirë, por ky është vendimi i klubit. Jam profesionist dhe duhet t'i zbatoj rregullat një më një. Unë u paraqita në stërvitje për arsye se jam pjesë e grupit, por në momentin që vajta në stërvitje, m'u paraqit një letër me shkrim se jam i pezulluar për dy ndeshje. Për momentin nuk më erdhi mirë, por janë vendime të klubit dhe duhet t'i pranoj. Dua t'i falënderoj jashtë mase për 4 vite që kam kaluar këtu dhe jam rritur si sportist. Do të më mungojnë shumë se kam krijuar edhe miqësi jashtë fushe, por shpresoj jo vetëm të më mungojnë, por do t'u mungoj edhe unë atyre. Nuk e prisja, sepse për nga

mënyra si u luajt ndeshja apo si i bëmë dhe pësuar golat nuk duhet të merrej vendim nga klubi, por që ditën e parë që kam firmosur me Luftëtarin, kam dhënë maksimumin në çdo moment", tha Aleksi. "Falënderoj Luftëtarin për çdo gjë, kam dhënë gjithmonë më të mirën për këtë skuadër. E kam dëgjuar argumentin e drejtuesve se unë nuk luajta mirë kundër Tiranës, edhe Mesi nuk luan në çdo ndeshje mirë. Edhe në ndeshje të tjera kam luajtur keq për Luftëtarin, kjo është normale për një futbollist. Kam dhënë maksimumin, sa i përket të ardhmes nuk e di. Do të kthehem në shtëpi, do të flas me menaxherin. Gjithsesi, për çdo vendim do t'ju vë në dijeni", u shpreh Xheksun.

TRONDITET ANGLIA

Familja Bin Laden financon Sheffield Junajtidin

Një zbulim i orëve të fundit ka tronditur pa masë botën e futbollit anglez dhe jo vetëm. Sheffield Junajtid, klubi që siguroi rikthimin në Premier Ligë pak ditë më parë, financohet nga familja e terroristit më të madh që ka njohur historia e njerëzitetit, Osama Bin Laden. Kjo u zbulua pas një gjyqi mes dy aksionerëve të klubit të Sheffieldit, Kevin MekKejb dhe princit Abdullah Bin Mosad Bin Abdolaziz Al Saud. Të dy ortakët zotërojnë secili nga 50% të aksioneve të klubit dhe janë në proces gjyqësor mes tyre për të siguruar 100% të aksioneve. Gjatë procesit, avokatët e MekKejb kanë nxjerrë në dritë financime të errëta të princit Abdullah Bin Mosad Bin Abdolaziz Al Saud, ku një shumë prej 3 milionë eurosh ka ardhur prej familjes Bin Laden. Tashmë mbetet për t'u parë se si do të mbrohet pala e akuzuar dhe se çfarë do të ndodhë me Sheffieldin.

VERË E ÇMENDUR NË MADRID

"Canal+": Jo vetëm Hazard, Reali do të blejë edhe Salah

Gjiganti televiziv francez, "Canal+ Sport", lëshon bombën e ditës sa i përket merkatos botërore dhe që ka në thelb mbretërorët nga Madridi, Realin, që mesa duket ka ndërmend të bëjë pazar të çmendur në Angli. Kështu, pas Eden Hazard, emri i radhës që do të braktisë ishullin për t'u bashkuar projektit të "Los Blancos", është Momo Salah. "Sa i takon Real Madridit dhe grupit të ri, pas Hazard, Zidan dhe Reali kërkojnë një tjetër sulmues të madh. Bëhet fjalë për Mohamed Salah. Menjëherë pas Hazardit, ky do të jetë prioriteti. Duan të ndërtojnë një tjetër trio të madhe sulmuese. Zidan nuk dëshiron më Bejlin nga e djathta, por Salah", pohoi Filip Karajon, gazetar i "Canal+".




"BRAND FINANCE"

Real Madridi, klubi më i çmuar në botë

Real Madridi është brandi futbollistik më i çmueshëm në botë. Vlerësimi vjen pas raportit të fundit të "Brand Finance", që e vlerëson Real Madridin me 1.664 miliardë euro. Kështu, skuadra madrilene merr vendin e parë duke zbritur në vendin e dytë Manchester Junajtidin, që vlerësohet me 1.472 miliardë euro. Në vendin e tretë është një tjetër klub spanjoll, Barcelona, me një vlerë prej 1.393 miliardë eurosh. Më pas vijon me 3 klube të tjera, që janë të gjitha me një vlerë mbi një miliard euro, vijon me Bajernin e Mynihut, 1.314 miliardë euro; Manchester Siti me 1.255 miliardë, Liverpooli 1.191. Këto top-6 klubit në botë së bashku përfaqësojnë 40% të brand-eve më të vlefshme në futboll. Në vendin e shtatë është Çelsi, me një vlerë prej 968 milionë eurosh, ndjekur nga Paris Sën Zhërmeni me 914 milionë euro. Në vendin e nëntë ndodhet Arsenali me një vlerë prej 885 milionë eurosh, ndërsa e mbyll renditjen e 10 ekipeve më të çmuara Tottenhami me 758 milionë euro. Siç mund të vërehet, asnjë ekip italian nuk ndodhet në top-10 klubit, pasi Juventusit gjendet vetëm në vendin e 11-të.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Ferguson trainer.
6. Grand Prix
8. Është stacion beduinësh.
11. Një artikull jo për vegjetarian
12. Kujt i vjen... di të bëjë.
14. Kaçaturian kompozitor
16. Logot pa kufij
17. Parashitesë për vetë.
19. Aktorja protagoniste e Vertigo.
21. Ndezur në aparaturë.
23. Është si telefilm.
24. Ai i shtatë është kinemaja.
26. Është me shumë se kërkesë.
28. Cristiano bomber të Real Madrid.
29. Teket e grave.
31. Në krye të masave.
32. Shkon goja... nga nepsi.

33. Duket të gjata ato të prithjes.
35. Gjysmë batak.

36. Është për medaljen e parë
37. Është kujdesi i babait.
- 39.... Maiden që këndojnë.
41. Një "bombë" tenistike.
42. Fillojnë mykjen
43. Janë këngëtarët si Jose Carreras
45. Është këngë e kënduar nga komiku
47. Lumë në Francë.
48. Piktori i Ura e Narnit.
49. Kapen në kufij

VERTIKAL

1. Në hyrje të ambientit
2. Neeson aktor.
3. Ente Sociale Rumune.
4. Ajo e zezë nënkpton arbitrin.
5. Kufizojnë stacionin.
6. Tremb fëmijët.
7. Jepet për t'u marrë.
8. Qytet japonez.
9. Është pemë
10. Janë tallësit.
13. Roberto trainer italian.
15. Freni këngëtare lirike.
18. Gjysmë totale.
20. Një si divan.
22. Tipare pa zë
23. Ulet në dhomën e lartë.
25. Moore aktor.
27. Qe bomber brazilian.
30. Ishte shpërthimi i Little Boy.
33. Carolina, e bukura e Belle époque.
34. Mbarojnë fare
35. Pullman aktor.
37. Është thëllimi
38. Meg aktore.
40. Ndërmarrje Industriale Rajonale.
41. Një lidhëz.
44. Kaluar në krye.
46. Fundi i Turandot.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Mund të hidhet te kiromanti
5. Teket e kafes.
8. D'Istria e Helena Gjikhës
12. Smith filozof.
13. Kuke regjisor
14. Një pjesë e minoritetit.
15. Moduli i Neil Armstrong.
16. Mund të jenë qitjeje.
19. Markë pistolete.
20. Mbyllin fushatat.
21. Është dorëzim.
22. Është detar.
23. Fillojë ilustrimet.
24. Është hon.
25. Diftong në duel
27. Një pjesë e rifillimit.
28. Një që kuron karien.
31. Nganjëherë duhen vënë mbi i.

VERTIKAL


4. Egër dhe e fortë.
34. Janë thëniet e famshme.
35. Janë trupa qiellore të tillë.
37. Inicialet e Stone regjisor
38. Memoria në computer
40. Në krye të trupave.
41. Mund të jenë diskografike.
44. Është e zakonshme për pushime
46. Skuadër greke.
47. Bel i Maupassant.
48. Është thesar.
4. Inicialet e Mallé regjisor
5. Mund të jetë telefonike
6. Ka dy faqe
7. Mund të jetë një cutter.
9. Në mes të dhomës.
10. Mbahet me bateri.
11. Përfshijnë edhe Haitin.
13. Denis i enëve me presion.
16. Paguhën për shërbime.
17. Janë ufo.
18. Ekstrema në tunel.
21. Një atentator vetëvrasës.
22. Markë cigaresh.
26. Arrihet duke mundur.
28. Jonathan, regjisor i Heshtja e qengjave.
29. Është aparati me zorrë.
30. Pak servilizëm.
31. Kështu e ka syrin vigjilent.
32. Fatih trainer turk.
34. ... Nostra me mafiozët.
36. Mbyllin punimet.
39. Ai i shenjtë është papa.
42. Kufizojnë në teknik.
43. Fillojnë panikun.
44. Fund tuneli.
45. Në krye të armatës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	7	4		8				
2					6			1
				1				3 5
		2					3	
7		8				4		
9				7 2			6	
			6					
							2 3	
5				1				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	6	4	2	3	8	7	5	9
8	5	9	4	7	6	1	2	3
7	3	2	1	5	9	4	8	6
9	4	1	6	8	5	2	3	7
2	7	5	3	9	4	6	1	8
6	8	3	7	1	2	5	9	4
3	9	7	5	6	1	8	4	2
4	1	6	8	2	3	9	7	5
5	2	8	9	4	7	3	6	1



Argëtim filozofik

- Duhet patur frikë nga ai që urren vetveten, sepse ti mund të jesh viktima e zemërimit dhe e hakmarrjes së tij.
- Sa më shumë që ngrihemi, aq më shumë të vegjëll dukemi në vështrimet e atyre që nuk dinë të fluturojnë.
- Është e lehtë të kesh parime kur je i pasur. Gjë e rëndësishme është të kesh parime kur je i varfër.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

D	A	V	I	D	R	O	C	K	L	K	R		
E	M	E	R	K	E	A	S	E	A	N	N		
M	A	L	O	T	K	E	N	E	T	A	T		
I	N	N	I	M	R	O	M	A	N	E	T		
R	P	A	S	I	V	E	T	M					
M	O	K	A	S	I	N	A	I	D	E	M		
E	M	I	R	A	T	I	A	V	A	T	I		
S	T	A	N	E	A	T	O	M	I	K	N		
A	R	S	T	R	E	T	E	O	D				
A	T	A	S	E	M	T	I	K	O	R	E		
A	T	A	T	A	K	A	T	I	D	A	R		
H	S	T	A	R	S	T	R	T	A	R	I		
B	A	L	E	N	A	A	M	M	O	T	I		
E	N	K	A	G	A	I	U	M	A				
K	T	M	I	K	R	K	A	R	A	T	E		
I	T	P	A	L	E	T	L	I	R	T	A		
M	A	I	P	E	T	A	L	E	T	M	R		
I	K	A	L	K	U	L	I	M	E	T	K	O	T
M	U	L	E	R	M	E	T	A	L	E			
A	N	B	E	T	A	I	R	P	O	T			
N	A	I	F	P	I	E	I	D	E				
E	T	I	E	M	I	N	A	T	O	R	E	T	
T	I	T	R	E	N	I	A	F	A	T	I		

FJALËKRYQI (2)



Thënie të mençura

- Drejtësia? Ju do të gjeni drejtësinë në botën tjetër.
- Në këtë jetë kemi vetëm ligje.
- Disa bëhen me turp kundrejt lavdërimeve të mëdha, të tjerët bëhen të paturp.
- Është gabim të lejosh që dita të gjykohej në mbrëmje, sepse atëherë, tepër shpesh lodhja bëhet gjykatëse e forcës, e suksesit dhe e vullnetit të mirë.

